



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 616 Akti

Nr. 745 Vendimi  
Tiranë, më 20.3.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Valbona Sanxhaktari</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Firdes Shuli</b>	<b>Relatore</b>
<b>Olsi Komici</b>	<b>Anëtar</b>

në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në datën 19.3.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Elda Vrioni**, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Elda Vrioni, e cila në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Znj. Elda Vrioni është subjekt rivlerësimi bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), për shkak të funksionit të saj si gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

2. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, znj. Elda Vrioni i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.12.2020, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Olsi Komici, Valbona Sanxhaktari dhe Firdes Shuli (relatore).

3. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga Komisioni janë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga: (i) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31-33 të ligjit nr. 84/2016; (ii) Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; (iii) Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Me vendimin nr. 1, datë 15.1.2021, trupi gjykues filloi hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, caktoi kryesuese komisioneren Valbona Sanxhaktari dhe deklaroi mungesën e konfliktit të interesit.

5. Me vendimin nr. 2, datë 10.1.2024, trupi gjykues administroi dosjen e bashkëshortit të subjektit, ish-subjekt rivlerësimi, z. M. K. Nëpërmjet komunikimit elektronik, në datën 12.1.2024, subjekti ka shprehur dakordësinë me deklaratimet e bashkëshortit të saj si dhe, pëlqimin për t’u përdorur gjatë procesit të saj të rivlerësimit.

6. Me vendimin nr. 3, datë 7.3.2024, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh prej relatores së çështjes me rezultatet e hetimit dhe me provat e grumbulluara për të tria kriteret, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Elda Vrioni; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 dhe 35 – 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave e thirrjen e dëshmitarëve dhe afatin e ushtrimit të tyre. Në datën 8.3.2024, subjektit iu dërguan rezultatet e hetimit administrativ dhe iu la afat për paraqitjen e parashtrimeve deri në datën 15.3.2024. Në datën 12.3.2024, subjekti i rivlerësimit ka marrë kopje të akteve të dosjes.

7. Me vendimin nr. 4, datë 16.3.2024, u vendos kalimi i çështjes në seancë dëgjimore, i cili iu komunikua subjektit në rrugë elektronike në datën 16.3.2024.

8. Në datën 19.3.2024, ora 10:00, u zhvillua seanca dëgjimore ku subjekti ishte i pranishëm dhe, në përfundim, kërkoi konfirmimin në detyrë.

9. Në datën 20.3.2024 u shpall vendimi për subjektin e rivlerësimit Elda Vrioni.

## **II. PARIME TË PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT**

10. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

11. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

**12.** Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin në lidhje me kontrollin e figurës. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

**13.** Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse, bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, duke marrë në analizë: (i) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja, deklaratat periodike vjetore (në vijim DPV) dhe dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga ky institucion vlerësimi; (ii) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar nga AKSIK-ja dhe dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga ky institucion vlerësimi; (iii) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja/KLP-ja dhe dokumentet shkresore të paraqitura prej tyre; (iv) provat shkresore/dokumentet e vëna në dispozicion nga institucionet apo subjektet publike a private; (v) denoncimet e publikut sipas nenit 53 të ligjit dhe çdo informacion të marrë në rrugë ligjore; (vi) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit; (vii) sugjerime/opinione të vëzhguesit të ONM-së sipas nenit 49, pikat 10-12 të ligjit.

### **III. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI**

#### **VLERËSIMI I PASURISË**

**14.** Në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit që ushtron detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën e pasurisë *Vetting* në datën 27.1.2017, me nr. indeksi \*\*\*.

**15.** ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për subjektin Elda Vrioni ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, në të cilin ka konstatuar se: (i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

**16.** Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit të rivlerësimit Elda Vrioni.

**17.** Hetimi administrativ në lidhje me rivlerësimin e pasurisë konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit në deklaratën *Vetting*; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklarimeve të rreme; (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim vërtetimin ose jo të deklarimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

#### **Pasuri të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting***

**18.** *Apartament banimi në bashkëpronësi me bashkëshortin me sip. 130 m<sup>2</sup>, ndodhur në Durrës, Lagjja nr. \*\*\*, rruga \*\*\*\*, pallati \*\*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, regjistruar pranë ZVRPP-së Durrës, me nr. pasurie \*\*\*, sipas kontratës së shitjes me kusht nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.9.2016, e lidhur me shoqërinë \*\*\*\* sh.p.k., në vlerën totale 75.000 euro. Burimet financiare krijuar nga të ardhurat ndër vite nga paga, angazhimet e tjera akademike e profesionale, të deklaruar prej meje. Nga shuma totale e apartamentit prej 75.000 euro prej meje është paguar shuma 21.000 euro, shuma 14.000 euro është paguar nga bashkëshorti,*

ndërsa pjesa e mbetur prej 40.000 euro është marrë me kredi të përbashkët pranë Alpha Bank. Zotërues 50 % nga vetë subjekti.

## **Hetimi i Komisionit për këtë pasuri**

**18.1** Në DPV-në e vitit 2016, subjekti e ka deklaruar këtë pasuri me të njëjtat të dhëna dhe burime. Në këtë deklaratë, subjekti ka deklaruar si adresë të plotë të regjistrimit në gjendjen civile, Lagjja nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*”, pallati “\*\*\*”, Durrës, Njësia Administrative Nr. \*\*\*, Durrës.

## **18.2. Në lidhje me përfitimën e pasurisë dhe deklaratimet e subjektit u konstatua se:**

Në bazë të kontratës së shitjes me kusht nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.9.2016, subjekti i rivlerësimit Elda Vrioni dhe bashkëshorti kanë blerë nga shoqëria ndërtuese “\*\*\*” sh.p.k., regjistruar me NIPT \*\*\* dhe drejtues ligjor E. D., pasurinë e llojit apartament me sip. 130 m<sup>2</sup>, ndodhur në Lagjen nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*”, Durrës, kundrejt çmimit 75.000 euro.

Sipas kartelës së pasurisë, pasuria nr. \*\*\*, apartament me sip. 130 m<sup>2</sup> figuron i regjistruar në datën 16.11.2016 në bashkëpronësi të shtetasve M. K. dhe E. V., me shënimin “Paguuar shuma 75.000, k. sh. kusht; d. noteriale nr. \*\*\*, datë 14.11.2016”.

FSHU-ja ka informuar Komisionin se me gjeneralitetet M. S. K., referuar të dhënave të sistemit të faturimit identifikohet 1 (një) abonent me kontratë furnizimi nr. \*\*\*, në instancën Durrës.

UK Durrës ka informuar se në emër të shtetasit M. S. K., i datëlindjes 5.1.1972, rezulton një kontratë furnizimi me shoqërinë UKD sh.a., me nr. \*\*\*, në adresën Lagjja nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*”, pallat i firmës “\*\*\*” sh.p.k.

## **18.3. Lidhur me kohën e pagesës së çmimit**

Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se nga vlera totale prej 75.000 euro e çmimit të blerjes së këtij apartamenti, nga ana e subjektit është paguar shuma 21.000 euro, shuma prej 14.000 euro është paguar nga bashkëshorti, ndërsa pjesa e mbetur prej 40.000 euro është marrë me kredi të përbashkët pranë Alpha Bank.

Referuar kontratës së shitjes me kusht të datës 19.9.2016, kësti i parë në shumën 35.000 euro, likuidohet nëpërmjet Alpha Bank në ditën e nënshkrimit të kontratës, ndërsa kësti i dytë në shumën 40.000 euro do të likuidohet nëpërmjet kredisë që do t’i akordohet blerësve nga Alpha Bank. Bashkëlidhur kësaj kontrate, në dosjen *Vetting* bashkëshorti i subjektit ka depozituar edhe 2 transfertë të brendshme të kryera prej tij dhe bashkëshortja në Alpha Bank me përfitues shoqërinë ndërtuese “\*\*\*” sh.p.k. Me transfertë të datës 19.9.2016 të Alpha Bank bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka transferuar në llogari të shoqërisë ndërtuese shumën 14.000 euro, ndërsa subjekti ka transferuar nga llogaria e saj për llogari të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. shumën 21.000 euro. Pas verifikimeve të kryera<sup>1</sup> nuk rezultoi ndonjë konflikt i mundshëm interesi i subjektit Elda Vrioni me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k. dhe shtetasin E. D.

## **18.4. Në lidhje me burimet financiare u konstatua se:**

Për shumën 14.000 euro, të paguar prej bashkëshortit, subjekti ka deklaruar se janë krijuar nga të ardhurat ndër vite nga paga, angazhimet e tjera akademike e profesionale, si dhe pjesëmarrja si gjyqtar *ad hoc* në GJEDNJ të deklaruara prej tij, ndërsa si burim financiar për shumën 21.000 euro të paguar prej saj, të ardhurat ndër vite nga paga, angazhimet e tjera akademike e profesionale të deklaruara prej saj çdo vit. I njëjti burim është deklaruar edhe nga personi i lidhur (bashkëshorti i saj).

Referuar deklaratimeve të interesave privatë vjetorë, për periudhën 2003 – 2015 subjekti ka deklaruar vetëm në DPV-në e vitit 2015 kursim në gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, shumën

<sup>1</sup> Shihni shkresat nr. \*\*\* prot., datë 23.1.2024, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier; nr. \*\*\* prot., datë 31.1.2024, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. \*\*\* prot., datë 29.1.2024, nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, në dosjen e Komisionit.

450.000 lekë. Ndërsa bashkëshorti i saj M. K. nuk ka deklaruar në asnjë vit gjendje, shtesë/pakësim të likuiditeteve *cash* në banesë.

Referuar të dhënave nga Alpha Bank<sup>2</sup>, rezulton se në datën 31.12.2015 bashkëshorti i subjektit M. K. ka pasur gjendje në llogari Alpha Start shumë 17.002,52 euro, ndërsa subjekti Elda Vrioni ka pasur gjendje në llogarinë në emër të saj në këtë bankë shumë 21.003,22 euro. Këto shuma e kanë burimin nga transferimi në llogari të znj. Elda Vrioni dhe të z. M. K., përkatësisht shumat 21.000 euro dhe 14.000 euro nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. në Alpha Bank, si zbatim i deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 2.10.2015<sup>3</sup>, me të cilën është revokuar kontrata e sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 21.5.2014.

### **18.5. Në lidhje me kontratën e sipërmarrjes për apartamentin me sip. 146 m<sup>2</sup>, në Lagjen nr. \*\*\*, Durrës dhe revokimin e saj u konstatua se:**

Në DPV-në e vitit 2014, bashkëshorti i subjektit M. K. ka deklaruar shpenzime për lidhjen e kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., dhe nr. \*\*\* kol., datë 21.5.2014, me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., për ndërtim apartamenti për pagim të pjesshëm të vlerës së kontraktuar në masën 14.000 euro, të cilat i janë kaluar subjektit sipërmarrës nëpërmjet Alpha Bank në datat 21.5.2014 dhe 9.7.2014, me burime të mirëpërcaktuara. Ndërsa subjekti i rivlerësimit Elda Vrioni ka deklaruar shpenzime për lidhjen e kësaj kontrate në shumë 21.000 euro. Pagesë e kryer *cash* në llogari të shoqërisë së ndërtimit në Alpha Bank në datën 23.5.2014 .

Referuar kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.5.2014, me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., porositesit M. K. dhe Elda Vrioni kanë porositur apartamentin me sipërfaqe të përgjithshme 146 m<sup>2</sup>, në Lagjen nr. \*\*\*, Durrës, kundrejt shumës 77.000 euro, për të cilin u pagua shuma 5.000 euro në datën 21.5.2014, kësti i dytë në shumë 30.000 euro, përcaktuar të paguhej brenda 20 ditëve nga dita e nënshkrimit të kontratës, kësti i tretë në shumë 35.000 euro, do të shlyhej nëpërmjet një kredie bankare dhe kësti i fundit do të paguhej me nënshkrimin e kontratës së shitblerjes.

Me deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 2.10.2015, deklaruesit shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori A. D. dhe porositesit M. K. e Elda Vrioni kanë deklaruar anulimin e kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.5.2014, dhe administratori i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. u ka kthyer porositesve shumë e paguar për porositjen e apartamentit prej 35.000 euro, nëpërmjet dy mandateve të Alpha Bank, dega Durrës. Në DPV-në e vitit 2015 subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë deklaruar shtim të të ardhurave nga revokimi i kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.5.2014, me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., përkatësisht shumat 21.000 euro dhe 14.000 euro.

### **18.6. Në lidhje me mundësitë financiare për pagimin e shumës 35.000 euro**

Deri në datën 9.7.2014, pasi janë analizuar të gjitha burimet e deklaruara nga bashkëshortët, janë verifikuar dokumentet shkresore që vërtetojnë të ardhurat e tyre, janë administruar të dhënat bankare, nga Komisioni u krye një analizë e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2014 – 9.7.2014, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur për kryerjen e pagesës së shumës 35.000 euro shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara/evidentuara dhe llogaritura për këtë periudhë.

<b>Analiza paraprake e treguesve financiarë për periudhën</b>	<b>1.1.2014 – 9.7.2014</b>
<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera në lekë</b>
Të ardhurat neto nga marrëdhënia e punësimit të subjektit të rivlerësimit, dokumentuar Alpha Bank për periudhën	726.221

<sup>2</sup> Shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 26.1.2021.

<sup>3</sup> Dokumentacion pjesë e shkresës kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 3.3.2021, nga ILDKPKI-ja.

Të ardhurat neto nga mardh. e punësimit të znj. E. Vrioni, dokumentuar Credins Bank për periudhën	530.587
Të ardhurat të znj. E. Vrioni, dokumentuar në Raiffeisen Bank për periudhën	36.000
Interesa subjekti për periudhën	2.975
<b>Total të ardhura/të hyra financiare</b>	<b>1.295.783</b>
Shpenzime udhëtimi dhe qëndrimi jashtë vendit	35.035
Shp. minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI për periudhën (për 2 person)	227.834
<b>Total shpenzime/të dala financiare</b>	<b>262.869</b>
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> gj. fillim – gj. fund periudhe	0
Ndryshim mj. monetare bankë, dokumentuar gj. fillim – gj. fund periudhe	4.086.286
<b>Mjete monetare të disponueshme (1)</b>	<b>5.119.200</b>
Pagesë për shoqërinë “****” sh.p.k. në lidhje me kont. sipërmarrjes datë 21.5.2014 shuma 35.000 euro	4.904.900
<b>Total pasuri</b>	<b>4.904.900</b>
<b>Detyrime financiare</b>	<b>0</b>
<b>Pasuri neto (2)</b>	<b>4.904.900</b>
<b>Balanca e fondeve (1-2)</b>	<b>214.300</b>

Sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur burime financiare të mjaftueshme për pagesën e çmimit të porositjes së blerjes së apartamentit në Durrës tek shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. në shumën 35.000 euro, deri në datën 9.7.2014, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara/evidentuara dhe llogaritura për periudhën 1.1.2014 – 9.7.2014.

**18.7. Sa i takon kredisë së përbashkët në Alpha Bank** u konstatua se me kontratën e huas datë 20.10.2016<sup>4</sup>, subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë përfituar nga Alpha Bank një hua në shumën 5.560.000 lekë, me qëllim për të financuar blerjen e apartamentit sipas kontratës së shitblerjes me kusht të datës 19.9.2016, lidhur mes shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., përfaqësuar nga shtetasi E. D. (pala shitëse) dhe M. K. dhe Elda Vrioni (pala blerëse), me objekt shitblerjen e pasurisë së llojit apartament me sip. 130 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, Durrës. Kjo hua është dhënë me një afat 180 muaj dhe si barrë hipotekore është vendosur pasuria apartament me sip. 130 m<sup>2</sup> në pronësi të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

Me transfertë të brendshme datë 24.10.2016 në Alpha Bank, nga llogaria e përbashkët M. K. ose Elda Vrioni, është transferuar në llogari të noterës A. Spahiu, person fizik shuma 5.560.000 lekë, me përshkrimin “M. K., Elda Vrioni për \*\*\*, kontratë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.9.2016”.

**18.8.** Nga Komisioni, në konsideratë të faktit që në vitin 2016, nga subjekti dhe personi i lidhur janë deklaruar edhe shpenzime për pasuri të luajtshme në vlerën 2.311.448 lekë (trajtuar me poshtë), për të cilat është deklaruar i njëjti burim të ardhurash, është vlerësuar që analiza paraprake e treguesve financiarë për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur për blerjen e apartamentit me sip. 130 m<sup>2</sup>, në Durrës, në shumën 75.000 euro, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara, të kryhet për të gjithë vitin e mbyllur 2016, pasqyruar si në tabelën më poshtë.

**18.9.** Në deklaratën *Vetting*: (i) subjekti ka deklaruar pasuri të luajtshme (pajisje elektroshtëpiake dhe mobilie) dhe burimet financiare. Vlera totale e paguar prej 2.311.448 lekësh, nga e cila subjekti ka paguar shumën 750.448 lekë; (ii) bashkëshorti i saj M. K. ka deklaruar pasuri të luajtshme (pajisje elektroshtëpiake dhe mobilie) me vlerë 2.311.448, nga e cila paguar prej tij 1.561.000 lekë dhe burimet financiare<sup>5</sup>, deklarime që përputhen me ato të

<sup>4</sup> Bashkëlidhur në dokumentacionin pjesë të dosjes *Vetting*.

<sup>5</sup> Shihni dokumentet e paraqitura në ILDKPKI.

DPV-së 2016. Referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti rezulton se shuma e faturuar prej 2.311.448 lekësh është likuiduar deri në datën 31.12.2016.

### Analiza e treguesve financiarë

**18.10.** Në përfundim të hetimit administrativ, nga Komisioni u krye analiza paraprake e treguesve financiarë për vitin 2016, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur për pagesën e çmimit të blerjes së apartamentit me sip. 130 m<sup>2</sup>, në Durrës, në shumën 75.000 euro, blerjen e pajisjeve elektroshtëpiake dhe mobileve në shumën 2.311.448 lekë, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara/evidentuara dhe llogaritura për periudhën 1.1.2016 – 31.12.2016 si në tabelën më poshtë, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur burime financiare të mjaftueshme të ardhurash ligjore.

<b>Analiza paraprake e treguesve financiarë për periudhën</b>	<b>Viti 2016</b>
<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera në lekë</b>
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit subjekti dokumentuar për periudhën	1.315.363
Të ardhura të tjera të subjektit, honorar nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut	66.668
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit të bashkëshortes dokumentuar për periudhën	1.141.021
Të ardhura si eksperte ligjore pranë OSCE bashkëjetuese/bashkëshorte	240.152
Të ardhura nga kredia në Alpha Bank në datën 20.10.2016	5.560.000
<b>Total të ardhura/të hyra financiare</b>	<b>8.323.204</b>
Pagesë këste kredie (përfshirë komisione) për periudhën	137.312
Shpenzime sigurimi/regjistrim mjete	34.140
Shpenzime për regjistrim pasurie në ZVRPP	153.000
Shpenzime arredim/mobilim/pajisje elektroshtëpiake	2.311.448
Shp. minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI për periudhën	470.184
<b>Total shpenzime/të dala financiare</b>	<b>3.106.084</b>
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> gj. fillim – gj. fund periudhe	450.000
Ndryshim mj. monetare bankë dokumentuar gj. fillim – gj. fund periudhe	5.870.493
<b>Mjete monetare të disponueshme (1)</b>	<b>11.547.500</b>
Pagesë për blerje apartamenti me sip. 130 m <sup>2</sup> , në Durrës, në shumën 75.000 euro	10.142.250
<b>Total pasuri</b>	<b>10.142.250</b>
<b>Detyrime financiare</b>	<b>0</b>
<b>Pasuri neto (2)</b>	<b>10.142.250</b>
<b>Balanca e fondeve (1-2)</b>	<b>1.395.363</b>

Në përfundim të hetimit administrativ nuk u evidentuan problematika në mënyrën e krijimit të pasurisë objekt vlerësimi (pasuria e paluajtshme dhe pajisjet elektroshtëpiake), deklaratimet e subjektit, si dhe justifikimin e burimeve të deklaruara me të ardhura të ligjshme.

### 19. Automjet tip “Ford Fiesta”, viti i prodhimit 2004

Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar automjet tip “Ford Fiesta”, viti i prodhimit 2004, të blerë më 9.11.2009, me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., me vlerë 300.000 lekë, në pronësi të saj, me burim të ardhurat nga paga dhe angazhimet akademike dhe profesionale të deklaruara prej saj. Në DPV-në 2009, subjekti ka deklaruar automjetin tip “Ford Fiesta”, blerë me kontratë datë 9.11.2009, në shumën 300.000 lekë, po nuk ka deklaruar burimin.

**19.1.** Gjatë hetimit administrativ DPSHTRR-ja<sup>6</sup> informoi se znj. Elda Vrioni ka të regjistruar automjetin tip “Ford Fiesta”, me targë \*\*\*, blerë me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 9.11.2009, për shumën 300.000 lekë (shumë e cila do të paguhet me regjistrimin e mjetit). Sipas

<sup>6</sup> Shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 26.1.2021.

akteve në dosje rezulton se shitësja këtë mjet e kishte blerë në shumën 2.500 euro më 28.10.2009 në Itali.

### **Analizë e burimit të të ardhurave dhe mundësia financiare**

**19.2.** Referuar deklaratës *Vetting*, për blerjen e kësaj pasurie (të krijuar para bashkëjetesës/martësës me z. M. K.), subjekti ka deklaruar si burim “Të ardhura nga paga dhe angazhime akademike dhe profesionale”. Në DPV-të për periudhën deri në vitin 2008, znj. Elda Vrioni ka deklaruar të ardhura nga paga dhe angazhime të tjera akademike dhe profesionale. Subjekti nuk ka të deklaruar gjendje kursimesh *cash* në banesë në datën 31.12.2008, ndërsa referuar gjendjeve në llogaritë bankare në këtë datë rezultojnë të depozituara: (i) në llogarinë e pagës në Raiffeisen Bank shuma 406.488 lekë; (ii) në llogarinë rrjedhëse në emër të saj në Intesa Sanpaolo Bank shuma 25.770 lekë.

Mbështetur në dokumentacionin e administruar, nga Komisioni u krye analiza paraprake e treguesve financiarë për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit për blerjen e automjetit tip “Ford Fiesta” për shumën 300.000 lekë, shtesën në likuiditet në llogaritë bankare, si dhe kryerjen e shpenzimeve të evidentuara për periudhën 1.1.2009 – 26.11.2009<sup>7</sup>, konkretisht:

<b>Analiza paraprake e treguesve financiarë për periudhën</b>	<b>1.1.2009 – 26.11.2009</b>
<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera në lekë</b>
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit të znj. E. Vrioni dokumentuar në RZB për periudhën	1,155,669.00
Të ardhura nga universiteti “Luarasi” dhe të tjerë të transferuara në ISP Bank për periudhën	63,069.00
<b>Total të ardhura /të hyra financiare</b>	<b>1,218,738.00</b>
Shp. minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI për periudhën (për 1 person)	123,145.00
Shp. interes + principal kredie	227,250.47
Shpenzime transporti dhe qëndrimi jashtë vendit	135,200.80
<b>Total shpenzime/të dala financiare</b>	<b>485,596.27</b>
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> gj. fillim – gj. fund periudhe	-
Ndryshim mj. monetare bankë dokumentuar gj. fillim – gj. fund periudhe	(101,446.00)
<b>Mjete monetare të disponueshme (1)</b>	<b>994,147.00</b>
Pagesë për blerje automjeti tip “Ford Fiesta” në shumën 300.000 lekë me kont. shitblerjeje datë 9.11.2009	300,000.00
<b>Total pasuri</b>	<b>300,000.00</b>
<b>Detyrime financiare</b>	<b>-</b>
<b>Pasuri neto (2)</b>	<b>300,000.00</b>
<b>Balanca e fondeve (1-2)</b>	<b>331,695.73</b>

**19.3.** Sa më sipër, duket se subjekti ka pasur burime financiare të mjaftueshme për pagesën e çmimit të blerjes së automjetit tip “Ford Fiesta” në bazë të kontratës së shitblerjes datë 9.11.2009, në shumën 300.000 lekë, shtesën në llogarinë bankare në Raiffeisen Bank, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara/evidentuara dhe llogaritura për periudhën 1.1.2009 – 26.11.2009.

### **20. Subjekti ka deklaruar gjendje në llogaritë bankare si vijojnë:**

<sup>7</sup> Në referencë të përcaktimeve të kontratës së shitjes në të cilën shuma prej 300.000 lekësh do të dorëzohet në kohën e regjistrimit të mjetit.



**20.1.** Gjendje në llogarinë personale nga paga dhe shpërblimet e deklaruara nga subjekti pranë Alpha Bank, në vlerat 21.565,46 lekë dhe 1.729.04 euro. Zotërues: 100%.

Në DPV-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar llogaritë personale nga paga dhe shpërblimet në Alpha Bank, konkretisht: (i) llogari e mbetur në lekë në datën 31.12.2016 në shumën 88.354.46 lekë; (ii) llogari e mbetur në euro në datën 31.12.2016, në shumën 1.730.14 euro.

Referuar të dhënave nga Alpha Bank<sup>8</sup>, konfirmohet llogaria në euro dhe gjendja e saj në datën e dorëzimit të deklaratës *Vetting* në vlerën 1.729 euro. Në këtë llogari në euro, në emër subjektit në këtë bankë është transferuar nga OSCE-ja në datën 10.8.2016, shuma 1.500 euro dhe në datën 7.12.2016 shuma 250 euro, shuma të cilat janë deklaruar edhe në deklaratën individuale vjetore të të ardhurave për vitin 2016 prej saj.

Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me krijimin dhe deklarimin e gjendjes në llogarinë personale të subjektit të rivlerësimit.

**20.2.** Gjendje në llogarinë e përbashkët të kredisë me bashkëshortin pranë Alpha Bank në vlerën 9.881,10 lekë. Zotëruese në masën 50%. Nuk u konstatuan problematika.

**20.3.** Llogari e hapur në Raiffeisen Bank me balancë në vlerën 99,38 lekë nga të dhënat bankare. Zotëruese në 100%. Nuk u konstatuan problematika.

**20.4.** Në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kredi bankare pranë Alpha Bank, dega Durrës, me qëllim blerjeje apartamenti në shumën 5.560.000 lekë, sipas kontratës së huas nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.10.2016, me kohëzgjatje sipas planit të kredisë 24.11.2016 – 24.10.2031 (15 vjet), kredi e përbashkët me bashkëshortin. Nga të dhënat bankare rezulton se deri më 25.1.2017 ka mbetur e pashlyer shuma prej 5.491.876,59 lekësh. Në përfundim të hetimit administrativ nuk kanë rezultuar problematika në lidhje me këtë detyrim financiar dhe deklarimet e subjektit përputhen me të dhënat shkresore të administruara.

## **21. Pasuri të deklaruara nga personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit M. K., ish-subjekt rivlerësimi**

**21.1.** Apartament banimi në bashkëpronësi me bashkëshorten, trajtuar më sipër.

**21.2.** Automjet tip “Daimler Chrysler”, viti i prodhimit 1999, blerë në datën 22.3.2008, me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., në vlerën 470.000 lekë, në pronësi të tij, me burim të ardhura nga paga ndër vite, angazhimet e tjera akademike dhe profesionale të deklaruara prej tij, deklaruar në DPV-në 2008. Siç vërehet, kjo autoveturë është blerë përpara se subjekti të martohej me bashkëshorten në vitin 2011. Në lidhje me këtë pasuri, nga ana e trupit gjykues që ka kryer procesin e rivlerësimit të bashkëshortit të subjektit, në përfundim të procesit është vlerësuar se bashkëshorti i subjektit ka rezultuar me një balancë negative në vlerën - 291.276 lekë për blerjen e kësaj autoveture, balancë e cila nuk e penalizon subjektin e rivlerësimit Elda Vrioni.

**21.3.** Pasuri e luajtshme, trajtuar më sipër.

**21.4.** Gjendje llogarie për të cilat nuk janë evidentuar problematika, si vijojnë:

- llogari personale nga paga dhe shpërblimet e deklaruara prej tij në vlerën 21.823.16 lekë pranë Alpha Bank dhe vlerën 243,38 euro;
- gjendje e përbashkët e kredisë me bashkëshortin pranë Alpha Bank në shumën 9.881.10 lekë;
- kartë krediti *Visa* dhe kartë krediti *American Express Gold* ku rezulton se *nuk ka detyrime sipas limiteve të kartës*.

**21.5.** Në rubrikën “Detyrime financiare”, personi i lidhur ka deklaruar kredi bankare pranë Alpha Bank, dega Durrës, me qëllim blerjeje apartamenti në shumën 5.560.000 lekë, sipas

<sup>8</sup> Shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 26.1.2021.

kontratës së huas nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.10.2016, me kohëzgjatje 15 vjet, mbetur pa shlyer shuma 5.491.877 lekë. Deklarimi përputhet me atë të subjektit të rivlerësimit dhe nuk kanë rezultuar problematika.

### **Konstatime të tjera**

**22.** Nga ana e trupit gjykues, që ka shqyrtuar çështjen e subjektit M. K., është hetuar në lidhje me kredinë e marrë nga subjekti Elda Vrioni në vitin 2004, nga ku ka rezultuar se:

Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.8.2022, Banka Amerikane e Investimeve informon Komisionin se shtetasja Elda Vrioni ka pasur pranë kësaj banke llogari rrjedhëse në lekë, hapur në datën 10.12.2004 dhe e mbyllur në datën 4.2.2013, llogari kredie në euro hapur në datën 9.12.2004, pasi ka marrë kredi hipotekore në shumën 10.000 euro, me afat maturimi 7-vjeçar. Komisioni hetoi mbi kontratën e kredisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9.12.2004, lidhur midis Bankës Kombëtare të Greqisë në cilësinë e kredidhënësit dhe kredimarrësit znj. Elda Vrioni, ku shuma e kredisë së dhënë është 10.000 euro, afati i kredisë 7-vjeçar, qëllimi i dhënies së kredisë është blerja e një apartamenti. Dorëzanës për këtë kredi janë shtetasit S. dhe F. V. (V.), prindërit e subjektit, të cilët kanë garantuar shlyerjen e kredisë me pasurinë nr. \*\*\* , vol. \*\*\* , f. \*\*\* , z. k. \*\*\* , Lagjja nr. \*\*\* , rruga “\*\*\*\*”, apartamenti nr. \*\*\* , Durrës, në bashkëpronësi të tyre. Objekti i kreditimit pasuria nr. \*\*\* , vol. \*\*\* , f. \*\*\* , z. k. \*\*\* , e llojit apartament, ka qenë në pronësi të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. Me kontratë shitjeje nr. \*\*\* , datë 9.8.2009, ka kaluar në bashkëpronësi të shtetasve F. dhe S. V. Me kontratë dhurimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.1.2018, ka kaluar në pronësi të shtetasit S. V.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, në lidhje me këtë kredi të shtetasës Elda Vrioni, qëllimin dhe destinacionin e saj, ndër të tjera, subjekti M. K. sqaron se: *“Kredia në fjalë ka të bëjë me bashkëshorten time dhe është marrë në një kohë (viti 2004) kur unë nuk kam pasur asnjë lidhje të afërt me të. Në pasojë, trajtimi i pyetjes është bërë nga sa më ka deklaruar bashkëshortja dhe sa i kanë deklaruar kësaj të fundit prindërit e saj. Sipas bashkëshortes Elda Vrioni, destinacioni i shumës së kredisë së marrë në vlerën 10.000 euro është marrë si ndihmesë për prindërit e saj, të cilët kishin lidhur marrëveshje për të blerë apartament nga subjekti “\*\*\*\*” sh.p.k. Kredia rezulton e lidhur midis Bankës Kombëtare të Greqisë si kredidhënëse dhe subjekteve Elda Vrioni si kreditore dhe prindërve të saj S. dhe F. V. si dorëzanës për garantimin e kredisë. Subjekti K. ka deklaruar se as bashkëshortja dhe as ai nuk kanë tërhequr ndonjë të drejtë që vjen nga kjo pasuri”.*

**22.1.** Në përfundim të hetimit të subjektit M. K., ashtu edhe të hetimit për subjektin Elda Vrioni, nuk janë konstatuar problematika në lidhje me marrëdhënien e kreditimit të subjektit Elda Vrioni, e cila ka qenë në periudhën para bashkëjetesës së saj me bashkëshortin M. K.. Por gjatë hetimit administrativ të subjektit Elda Vrioni, duke marrë në konsideratë që kjo ka kontribuar me kredinë 10.000 euro në blerjen e apartamentit nga prindërit e saj gjatë periudhës që jetonte me ata dhe në kushtet kur pasuria është krijuar gjatë kohës që subjekti ka qenë në detyrë, për një hetim gjithëpërfshirës në lidhje me këtë apartament u kryen verifikimet si vijojnë:

- Me konfirmim të ASHK Durrës<sup>9</sup>, prindërit e subjektit të rivlerësimit, S. dhe F. V., kanë blerë apartamentin nr. pasurie \*\*\* , z. k. \*\*\* , me sip. 130 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, hyrja \*\*\* , ap. \*\*\* , Durrës, nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. në datën 9.8.2009, me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol. Në kontratën e shitblerjes konstatohet se mbiemri i babait të subjektit është S. V. dhe jo V. (nga certifikata e trungut familjar me datë lëshimi 6.1.2021 vërtetohet se në vitin 2003 është bërë ndryshimi i mbiemrit nga V. në V.). Gjithashtu, në këtë kontratë duket se apartamenti është blerë me çmim më të ulët sesa çmimi i tregut (6.500.000 lekë kundrejt çmimit të tregut 9.100.000 lekë). Nëpërmjet kontratës së dhurimit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë

<sup>9</sup> Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 3.10.2022 dhe dokumentet që gjenden bashkëlidhur në dosjen e Komisionit.

18.1.2018, ky apartament i është dhuruar vëllait të subjektit të rivlerësimit, shtetasit S. V., pa kundërshpërblim.

- Komisioni i ka kërkuar informacion subjektit “\*\*\*\*” sh.p.k., por nuk është kthyer një përgjigje, pasi nuk është arritur të gjendet vendndodhja e subjektit.

- Në pyetësonin nr. 2, subjektit i është kërkuar të sqarojë dhe dokumentojë: (a) burimin e ligjshëm të të ardhurave të prindërve për blerjen e këtij apartamenti; (b) të sqarojë dhe të dokumentojë lidhur me mënyrën e pagesës së çmimit të blerjes; (c) të sqarojë nëse ka kontribuar në pagesën e çmimit të kësaj pasurie; (ç) nëse nga kredia e marrë në Alpha Bank prej 10.000 euro është përdorur e gjithë shumata apo një pjesë e saj për likuidimin e vlerës së këtij apartamenti.

- Në përgjigje të pyetësonit nr. 2, subjekti paraqiti dokumentacion dhe sqaroi si vijon:

**Së pari**, sa i takon burimit të të ardhurave të ligjshme të prindërve, subjekti deklaroi të ardhurat e prindërve ndër vite, si dhe paraqiti dokumente shkresore (pasqyruar hollësisht në rezultatet e hetimit administrativ) në lidhje me: (a) të ardhura nga biznesi familjar agjenci për bileta; (b) të ardhura nga interesat bankare; (c) të ardhurat e krijuara nga dhënia me hua e kursimeve pranë kompanisë huamarrëse “\*\*\*\*”; (ç) të ardhura nga pensioni i pleqërisë së babait të subjektit.

**Së dyti**, në lidhje me mënyrën e pagesës së apartamentit të blerë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në mënyrë të përmbledhur subjekti ka sqaruar se:

- Për aq sa i është shpjeguar nga prindërit e saj, likuidimi i vlerës së apartamentit nga ana e tyre është kryer me pagesa *cash*, pasqyruar në mandatarkëtime të thjeshta për subjektin ndërtues, të cilat ata nuk i disponojnë më sot si dokumente fizike për shkak se ka kaluar shumë kohë dhe kalimi i pronësisë mbi apartamentin është bërë që në vitin 2009. E vetmja pagesë e kryer me transfertë bankare në favor të shoqërisë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k. është ajo e lidhur me kredinë bankare të marrë prej subjektit në shumën 10.000 euro në dhjetor të vitit 2004 (të cilën subjekti e ka deklaruar në DPV-në 2004, në ILDKPKI dhe përpara Komisionit), pagesë, e cila ka kaluar në llogari të shoqërisë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k.

- Për nevojën të përcaktimit të periodicitetit të pagesave dhe shumave konkrete në mandatarkëtimet e lëshuara prej shitësit, subjekti deklaroi se prindërit e saj i janë drejtuar shoqërisë tregtare “\*\*\*\*” sh.p.k. për të kërkuar një kopje të tyre, mirëpo përfaqësuesi ligjor i saj Th. G. shprehet se për praktikën dokumentare të apartamentit në fjalë nuk ka të ruajtura mandatarkëtime dhe as libër arke dhe se disponon vetëm kontratën e shitblerjes për apartament banimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9.7.2009.

- Për të njëjtin qëllim, subjekti i është drejtuar Drejtorisë Vendore të ASHK-së Durrës, duke i kërkuar nëse ndodhet kontrata e sipërmarrjes në praktikën dokumentare që lidhet me apartamentin e blerë nga prindërit e saj sipas kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9.7.2009 të noteres E. A., nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*. Në përgjigjen e saj nr. \*\*\* prot., datë 5.2.2024, Drejtoria Vendore Durrës pranë ASHK-së, konfirmon se nga verifikimi në sistemin multifunksional në arkivin ligjor, kontrata e sipërmarrjes nuk ndodhet.

- Për të shteruar mundësinë e kërimit, subjekti i është drejtuar me shkresë Bankës Amerikane të Investimeve (ABI Bank), e cila rezulton të ketë blerë në vitin 2017 Bankën Kombëtare të Greqisë S.A., (NBG), ku u mor kredia prej 10.000 euro. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.2.2024, ABI Bank kthen përgjigje se nuk disponon dosjen e kredisë.

- Sipas subjektit, nga komunikimi me prindërit ata deklarojnë se pagesa për porositjen/blerjen e këtij apartamenti ka filluar të kryhet gjatë vitit 2004 (në fund të vitit u disbursua edhe kredia) dhe ka përfunduar në vitin 2005, që është koha e marrjes në dorëzim të apartamentit. Po kështu, deklaroi se kontrata për furnizim me energji elektrike për apartamentin rezulton e hapur më 31.7.2005. Subjekti u referohet lëvizjeve bankare, sipas të cilave: (i) në vitin 2004, prindërit e subjektit kanë tërhequr shumën 15.000 USD nga ProCredit Bank, të cilën deklarojnë se e kanë

përdorur për pagesën e apartamentit (15.000 x 94.58 = 1.418.700 lekë); (ii) në vitin 2005, ata kanë ndërprerë një depozitë kursimesh pranë ish Bankës së Kursimeve (shkurt 2005), në vlerën 1.000.000 lekë, e cila sipas deklarimeve të tyre ka shkuar për pagesën e apartamentit<sup>10</sup>; (iii) po në vitin 2005, nga llogaria e tyre bankare pranë BKT-së, dega Durrës, rezultojnë një tërheqje në shumën 309.765, më 18.4.2005, që sipas tyre ka pasur të njëjtin qëllim<sup>11</sup>.

- Subjekti ka deklaruar se për shkak të aktivitetit ekonomik dhe mundësisë së kursimeve në vite, prindërit e saj kanë pasur mundësi për të paguar *cash* edhe pjesën tjetër të çmimit të apartamentit gjatë kësaj periudhe. Sa i takon vonesës në lidhjen e kontratës së shitblerjes në vitin 2009, kjo lidhet me vonesën në regjistrimin e vetë apartamentit në emër të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe, konkretisht, apartamenti i shitur prindërve të subjektit rezultojnë të jetë regjistruar në emër të shoqërisë në datën 7.7.2009 sipas vërtetimit nga dokumenti hipotekor, ndërsa kontrata është lidhur menjëherë më pas, në datën 9.7.2009.

- Për të provuar deklaratimet më sipër, subjekti ka vënë në dispozicion disa dokumente shkresore.

**Së treti**, sa i takon faktit nëse ka gjuvuar çështje ku palë ndërgjyqëse kanë qenë shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe/ose përfaqësuesi ligjor i saj, z. Th. G., subjekti ka deklaruar se nga ana e saj nuk është gjuvuar asnjë çështje gjyqësore. Për të vërtetuar deklaratimet e saj, ajo ka vënë në dispozicion vërtetimet e lëshuara respektivisht nga të gjitha gjykatat ku ajo ka ushtruar detyrën e gjyqtarës në shkallë të parë, si dhe për sa kohë ka gjuvuar çështje si gjyqtare e deleguar pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

**Së katërti**, për sa i takon kontributit që subjekti ka dhënë për blerjen e apartamentit dhe nëse shuma e kredisë prej 10.000 euro ka shkuar e tëra për qëllim, subjekti ka deklaruar se:

- Përveç kredisë, e cila është marrë nga subjekti dhe ka shkuar tërësisht në llogari të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. me transfertë bankare për llogari të blerjes së shtëpisë nga prindërit, për shkak se ka jetuar me prindërit në të njëjtën ekonomi familjare gjatë periudhës qëkur u mor kredia në vitin 2004 deri në vitin 2010 (pasi në vitin 2011 ka filluar të bashkëjetojë me bashkëshortin M. K.), të ardhurat e saj gjatë kësaj periudhe janë çuar në shtëpi dhe janë administruar përbashkërisht nga nëna e saj. Ajo ka deklaruar se ka përbashkuar shpenzimet e jetesës për vetë për këto vite deklarimi (sikundër e ka deklaruar edhe në pyetësorin standard), porse duke jetuar së bashku me familjen në të njëjtën shtëpi dhe ekonomi familjare, ajo që kapërcente masën e nevojave të saj ishte kontributi i saj për familjen. Por, sipas subjektit, është praktikisht e pamundur që të ndajë se cila masë e kontributit të saj nga të ardhurat është destinuar për cilin shpenzim të familjes. Pavarësisht nga ky fakt, subjekti sqaron se vendimi për të blerë një apartament ishte i prindërve të saj e jo i saj dhe, nga ana tjetër, për shkak se ajo pagën e çonte në shtëpi dhe banka kredidhënëse i kërkonte pagesat e përmuajshme pranë sporteleve të saj, kjo pagesë e vlerës së kredisë u dorëzohej çdo muaj prindërve të saj, në mënyrë që ata rregullisht të depozitonin pagesat në sportel, duke qenë se subjekti e kishte të pamundur për shkak të vendit të ushtrimit të detyrës gjithnjë larg vendit të banimit (2005 – 2007 në Fier dhe 2008 – 2011 në Tiranë). Për të provuar deklaratimet, subjekti ka vënë në dispozicion dokumentet provuese që vërtetojnë faktin se e gjithë shuma e kredisë prej 10.000 euro ka shkuar për shlyerjen e një pjese të çmimit të blerjes së pasurisë nga prindërit.

- Subjekti deklaroi se për pasurinë e përfituar nga prindërit e saj, ajo nuk ka tërhequr asnjë të drejtë pronësore apo posedimore pasi kjo pasuri nga pikëpamja juridike ka qenë në pronësi të prindërve të saj që në vitin 2009 dhe në vitin 2018 i ka kaluar me dhurim vëllait të saj S. V., për shkak se ky i fundit ka kontribuar në biznesin familjar, por edhe në kuadër të një investimi për të ardhmen e tij, të parë të lidhur me kohën e pleqërisë së tyre dhe mbështetjes tek djali. Në këtë aspekt, jo vetëm kjo pronë nuk lidhet me subjektin, por për të ajo as nuk ka ndonjë

<sup>10</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.2.2024, të Raiffeisen Bank, dega Durrës, bashkë me kopje të kartelave të tri depozitave të kursimit dhe statement bankar, lëshuar nga BKT-ja, dega Durrës, për depozitën bankare në emër të prindërve të subjektit, viti 2002, lëshuar në datën 29.1.2024, bashkëngjitur dokumenteve për përgjigjen e pyetësorit nr. 2.

pritsmëri në të ardhmen mbi baza trashëgimie, në kushtet kur është një pasuri që i është dhuruar vëllait të saj.

**22.2.** Bazuar në deklaratimet e subjektit dhe në të dhënat e dokumenteve bashkëlidhur në përgjigje të pyetësorit nr. 2, në lidhje me apartamentin e blerë nga prindërit e subjektit në vitin 2009, në vlerën 6.500.000 lekë, në përfundim të hetimit administrativ rezultoi se:

- i) përveç kredisë 10.000 euro transferuar shoqërisë së ndërtimit dhe kontributit të saj në shpenzimet familjare, nuk rezulton një kontribut i subjektit në krijimin e kësaj pasurie. Për më tepër, nga analiza financiare duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për të mbuluar shlyerjen e kredisë;
- ii) nga deklaratimet në ILDKPKI apo nga çdo e dhënë tjetër nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit ta ketë përdorur këtë banesë dhe nuk është vërtetuar se ajo ka fituar ndonjë të drejtë reale nga ky apartament;
- iii) pronësia e apartamentit i ka kaluar vëllait të saj në vitin 2018 me akt dhurimi, pa e përfshirë subjektin në trashëgiminë e këtij të fundit;
- iv) nuk ka të dhëna për ndonjë konflikt në tërësi të subjektit me shoqërinë e ndërtimit ose administratorin e saj.

Në këto kushte, nuk ka rezultuar asnjë tregues që të hedhë dyshime për pasurinë e blerë nga prindërit e subjektit në vitin 2009 e, për rrjedhojë, ata nuk duhet të konsiderohen si persona të lidhur ose të tjerë të lidhur.

**22.3.** Megjithatë, për një vlerësim të aftësive paguese të tyre për pjesën e mbetur të çmimit të shitjes (përfshirë kredinë 10.000 euro të marrë nga subjekti i rivlerësimit), e cila sipas deklaratimeve të subjektit dhe të dhënave të administruara është kryer *cash* gjatë viteve 2004 – 2005, Komisioni i është referuar të dhënave të dokumentuara si vijojnë:

- xhiroja e veprimtarisë së biznesit të babait (aksioner i vetëm) në vitet 2001 – 2005 është në vlerën rreth 10 milionë lekë. Fitimi vlerësohet në masën 7.8 milionë lekë (bazuar në interpretimin e fitimit të aksionerit të vetëm në çështjen e Kolegjit për E. K. dhe duke marrë në konsideratë një marzh fitimi mesatar 73%, referuar përgjigjes së DRT-së, drejtuar ILDKPKI-së në lidhje me fitimin e biznesit gjatë viteve 2005 – 2006);
- paga e nënës gjatë viteve 2001 – 2005 ishte 316.914 lekë;
- pensioni i babait gjatë kësaj periudhe 2001 – 2005 ka qenë 493.910 lekë;
- ka një shumë prej 2.4 milionë lekësh të konfirmuara se është tërhequr nga nëna nga ish-skemat piramidale;
- të ardhurat nga interesi nga depozitat ishin në vlerën 755.520,13 lekë;
- shpenzimet e jetesës ishin në vlerën 970.026 lekë;
- gjendja e llogarisë bankare të prindërve ishte në total 1.4 milionë lekë në fund të vitit 2005;
- çmimi i mbetur i apartamentit 5.2 milionë lekë.

Nga një analizë e këtyre të dhënave nuk mund të konkludohet që prindërit e subjektit kanë qenë në pamundësi financiare për blerjen e apartamentit gjatë viteve 2004 – 2005.

**23.** Sipas të dhënave të Intesa Sanpaolo Bank rezulton se është hapur një depozitë në shumën 50.000 euro në llogarinë e përbashkët të prindërve të subjektit të rivlerësimit (llogari dyemërore S. dhe F. V.) më 19.9.2013. Përshkrimi i transaksionit: “Tërhequr nga UBA Bank dhe ProCredit Bank në datën 12.9.2013”.

**23.1.** Në lidhje me këtë depozitë u kryen verifikimet e mëposhtme:

- Me kërkesë të Komisionit ProCredit Bank, UBA Bank dhe Raiffeisen Bank kanë paraqitur informacionet bankare për prindërit e subjektit.
- Në pyetësorin nr. 2, subjektit iu kërkua të sqarojë në lidhje me: (i) burimin e të ardhurave me të cilën është hapur depozita bankare në shumën 50.000 euro pranë Intesa Sanpaolo Bank më 19.9.2013; (ii) nëse ka pasur llogari bankare pranë UBA Bank babai i saj; (iii) a ka pasur llogari

bankare pranë ProCredit Bank babai i saj me emrin S. V. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka dhënë deklarime të detajuara dhe një numër të konsiderueshëm aktesh shkresore, pasqyruar në mënyrë të hollësishme në rezultatet e hetimit administrativ.

**23.2.** Në analizë të të gjitha të dhënave të administruara, në përfundim të hetimit rezultoi se:

- Llogaria është hapur *cash* nga babai i subjektit në vitin 2013 në shumën 50.000 euro në Intesa Sanpaolo Bank me burim të deklaruar nga 2 depozita në UBA dhe PCB Bank. Gjatë vitit 2013 është tërhequr vetëm një shumë prej 10.158,16 euro nga llogaria bankare në UBA (origjina e kësaj të fundit ka ardhur nga derdhja *cash* në vitin 2009 në këtë llogari që më pas është vendosur si depozitë). Sipas përgjigjes së PCB Bank, rezultoi se pranë kësaj banke ka transaksione tërheqje ndër vite nga llogaritë e prindërve të subjektit<sup>12</sup>. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim të ardhurat e prindërve dhe të vëllait të saj nga aktiviteti tregtar<sup>13</sup> dhe nga punësimi<sup>14</sup> dhe nga pensionet<sup>15</sup>, si dhe ka paraqitur dokumente që vërtetojnë të ardhurat e tyre.

- Depozita prej 50.000 euro është hapur gjatë kohës që subjekti i rivlerësimit nuk jetonte me prindërit e saj dhe ishte në një ekonomi të përbashkët që nga fillimi i bashkëjetesës me shtetasin M. K. në vitin 2011.

- Nga aktet e administruara gjatë hetimit, nuk rezultojnë të dhëna apo dyshime që lidhin subjektin e rivlerësimit me depozitën 50.000 euro në emër të babait të subjektit të rivlerësimit e si rrjedhojë ky i fundit nuk mund të kualifikohet si person tjetër i lidhur që do ta ngarkonte subjektin me detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e krijimit të këtyre kursimeve.

**24.** Nga verifikimi në regjistrin e noterëve të Ministrisë së Drejtësisë, sipas përgjigjes<sup>16</sup> së kësaj ministrie (regjistri noterial) është vërejtur një adresë e deklaruar si adresë e babait të subjektit të rivlerësimit: “Rr. “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, Durrës” me datë kryerje regjistrimi 12.6.2014. Në pyetësorin nr. 2, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këtë adresë banimi, duke vërtetuar me dokument shkresor pronësinë/posedimin nga babai i subjektit mbi pasurinë që i përket kësaj adrese. Në përgjigje, subjekti ka deklaruar se *nga komunikimi me prindërit e saj, veprimi noterial i datës 12.6.2014 është vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore, me kërkues babain e saj S. V. për të ndjerin të atin e tij. Nga verifikimi i dosjes fizike për lëshimin e aktit noterial nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 12.6.2014 “Dëshmi trashëgimie ligjore” nga notere D. H., rezultoi se adresa e shënuar në këtë akt: “Rruga “\*\*\*\*”, pall. \*\*\*” është shënuar mbi baza të adresës që figuron në certifikatën personale të babait tim S. V., akt i lëshuar nga ZGJC-ja pranë Njësisë Bashkiake nr. \*\*\*, Durrës, me nr. \*\*\* serie, në datën 8.1.2014. Kjo certifikatë është nxjerrë për qëllime të lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë (shënim i vetë certifikatës). Mirëpo kjo adresë që pasqyrohet në këtë certifikatë (“rruga “\*\*\*\*”,*

<sup>12</sup> Shuma 10.000 USD në datë 29.06.2004, shuma 5.006 USD në datë 24.09.2004, shuma 2.100.000 lekë në datë 09.10.2007.

<sup>13</sup> Vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës nr \*\*\* prot datë 30.01.2024 ku për tatimpaguesin \*\*\* shpk me ortak të vetëm S. V. konfirmohet se subjekti se ka ushtruar aktivitet për periudhën 2001-2012, ka xhiro për vitin 2001-2006 në vlerën 12.300.000 lekë, ndërsa për vitin 2007 deklarimi bëhej në Bashki, për vitin 2008 dhe 2009 xhiro rezultoi 0, ndërsa për periudhën 2010-2012 nuk ka informacion. Vërtetim i Bashkisë nr 110 prot datë 30.01.2024 ku vërtetohet se subjekti \*\*\* është taksuar për vitin 2007 për xhiron 2- 3 mil lekë. Vërtetim i Bashkisë nr 119 prot datë 29.01.2024 ku vërtetohet se subjekti S. V. -person fizik NIPT \*\*\* është taksuar për vitin 2011 dhe 2012 dhe periudhën e tremujorit të parë të vitit 2013, për xhiron 2- 3 mil lekë. Vërtetim i Bashkisë nr \*\*\* prot datë 29.01.2024 ku vërtetohet se subjekti S. V. -person fizik NIPT \*\*\* është taksuar për periudhën 2013, për xhiron 2- 3 mil lekë. Vërtetim i Bashkisë nr \*\*\* prot datë 29.01.2024 ku vërtetohet se subjekti S. V. -person fizik NIPT \*\*\* është taksuar për periudhën 2009-2010, për xhiron 2- 3 mil lekë.

<sup>14</sup> Vërtetim nga ProCredit Bank për punësimin e shtetasit S. V. nga data 19.03.2007-15.06.2010 dhe pagën e këtij të fundit. Vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës nr \*\*\* prot datë 03.10.2016, ku konfirmohen të ardhura nga paga 46.126 lekë për periudhën Dhjetor 2010- Shtator 2011. Vërtetim nga ZVRPP Durrës datë 24.01.2017 ku konfirmohen të ardhura nga paga për periudhën 2013-2016 në vlerën totale 2.219.110 lekë.

Vërtetim për bazën e vlerësueshme të shtetasit F. V. nga ISSH për periudhën 2001-2007.

<sup>15</sup> Vërtetim DRSSH nr \*\*\* prot datë 09.10.2018, ku vërtetohet se F. V. përfiton pension pleqërie në masën 15.908 lekë në muaj me datë fillimi pensioni 09.04.2009. Vërtetim DRSSH nr \*\*\* prot datë 31.01.2019, ku vërtetohet se S. V. përfiton pension pleqërie në masën 19.575 lekë në muaj dhe pension suplementar 9.539 lekë me datë fillimi pensioni pleqërie 01.03.1990, me datë fillimi pensioni suplementar 01.07.2009.

<sup>16</sup> Shihni shkresën kthim-përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 12.11.2021, të ardhur nga Ministria e Drejtësisë në dosjen e Komisionit.

*pall. \*\*\*”) nuk është e babait dhe nuk i përgjigjet aspak realitetit. Më tej, subjekti ka deklaruar se prindërit e saj dhe ajo bashkë me ta dhe vëllain S. V. kanë jetuar në pallatin nr. \*\*\*, në krah të rrugës “\*\*\*\*”, në Durrës (rrugë kryesore), në apartamentin e privatizuar nga prindërit e saj nga NKB-ja dhe, më pas, ata kanë jetuar në shtëpinë e blerë në vitin 2009 nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. Ajo ka theksuar se këto janë të vetmet apartamente banimi që prindërit e saj kanë pasur në pronësi dhe posedim dhe nuk kanë asnjë tjetër.*

**24.1.** Subjekti ka paraqitur një panoramë të detajuar të veprimeve të kryera nga zyra e gjendjes civile për regjistrimin e adresës së babait të saj bazuar në një numër të konsiderueshëm aktesh shkresore dhe ka vërtetuar se adresa e deklaruar si adresë e babait të subjektit të rivlerësimit: “Rr. “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\* Durrës” në dëshminë e trashëgimisë së shtetasit M. V. nuk është e babait të subjektit dhe nuk i përgjigjet realitetit, por është shënuar gabimisht nga zyra e regjistrimit të gjendjes civile.

**25.** Nga të dhënat e OSHE-së figurojnë 4 kontrata të konfirmuara për shtetasin S. V., babai i subjektit të rivlerësimit: 3 janë në qytetin e Durrësit, ndërsa e katërta është në \*\*\* (fshat). Në pyetësoin nr. 2, subjektit iu kërkua të japë sqarime dhe të paraqesë dokumente shkresore në lidhje me këto kontrata. Në përgjigjet e veta, subjekti ka deklaruar se nga këto katër kontrata, vetëm dy i përkasin babait të saj S. M. V., duke vërtetuar se:

i) Kontrata nr. \*\*\*, në Durrës, i përket apartamentit të banimit të blerë prej prindërve të saj nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9.7.2009, pranë noteres E. A. (trajtuar ky apartament gjerësisht në pyetjen nr. 1).

ii) Kontrata Nr. \*\*\*, në instancën Durrës, i përket apartamentit të banimit të privatizuar nga prindërit e saj nga Ndërmarrja Komunale Banesa në vitin 1993, që është shtëpia ku subjekti ka lindur dhe ka jetuar për 40 vjet, ende në emër të prindërve të saj.

iii) Sa i përket dy kontratave të tjera, subjekti ka deklaruar dhe ka vërtetuar me një numër të konsiderueshëm aktesh shkresore se ato nuk kanë asnjë lidhje me babain e saj S. V., pra nuk janë objekte në pronësi apo posedim të tij.

**26.** Subjekti është pyetur për personat që ka udhëtuar sipas sistemit TIMS dhe ka dhënë shpjegime në lidhje me pronarët dhe qëllimin e udhëtimeve. Për sa i takon shpenzimeve të kryera gjatë udhëtimeve jashtë vendit, ato janë përfshirë në analizën financiare sipas standardit të vendosur nga Kolegji në lidhje me çmimet e biletave dhe shpenzimeve ditore të qëndrimit.

**26.1.** Në përfundim të hetimit administrativ është kryer analiza financiare për subjektin Elda Vrioni, nga e cila nuk kanë rezultuar balanca negative.

## **KONTROLLI I FIGURËS**

**27.** Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

**27.1.** Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar raportin nr. \*\*\* prot., datë 21.11.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Elda S. Vrioni (V.), i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.3.2021, të KDZH-së, nga ku rezulton se: (i) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimin të organizuar. Në konkluzion të këtij raporti, AKSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Elda S. Vrioni (V.). Pasi është kërkuar

përditësimi i të dhënave, ka rezultuar se nuk disponohen të dhëna të përditësuara për subjektin Elda S. Vrioni (V.).

**27.2.** SPAK-u<sup>17</sup> ka informuar se: (i) ndaj shtetasës Elda Vrioni është regjistruar kallëzimi penal nr. \*\*\*, për të cilin pas verifikimit është vendosur mosfillim. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 12.2.2020, gjykata e posaçme ka vendosur shfuqizimin e mosfillimit duke u regjistruar procedimi penal nr. \*\*\* për veprën penale të nenit 245/1, pa asnjë emër dhe pas verifikimeve është vendosur shpallja e moskompetencës dhe kalimi në Prokurorinë e Rrethit Tiranë. Pas verifikimeve rezultoi se në këtë prokurori është duke u shqyrtuar një çështje, e cila është në fazën e hetimit, si dhe për këtë çështje nuk ka të dhëna që të jetë regjistruar emri i subjektit të rivlerësimit; (ii) në Prokurorinë e Krimeve të Rënda nuk rezulton që në emër të shtetasës Elda S. Vrioni të jetë regjistruar ndonjë procedim penal; (iii) ndaj shtetasës Elda Vrioni është regjistruar kallëzimi penal nr. \*\*\* për të cilin është vendosur mosfillim.

- Komisioni i ka drejtuar shkresë SPAK-ut për informacion në lidhje me personat që ka udhëtuar subjekti nëse kanë përfshirje në krimin e organizuar. Në kthim përgjigjen e kësaj shkrese me nr. \*\*\* prot., datë 29.1.2024, SPAK-u ka informuar se në emër të shtetasve të cituar në shkresë nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal apo pasuror.

**27.3.** Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni nuk evidentoi fakte dhe rrethana që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit, të cilat do të ndryshonin konstatimin fillestar të Grupit të Punës së AKSIK-së, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit Elda Vrioni është i përshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës, për shkak se ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**28.** Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit Elda Vrioni, bazuar në: raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë i Gjyqësor me nr. \*\*\* prot., datë 30.6.2022, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 27.7.2022; informacionin e marrë nga burime të ligjshme dhe kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**29.** Raporti për analizimin e aftësive profesionale, kryer nga KLGJ-ja, është bazuar në formularin e vetëdeklarimit, tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe në të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit, pesë dosjet gjyqësore të shortuara dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së. Pasi ka analizuar të dhënat si më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vlerësuar subjektin e rivlerësimit Elda Vrioni si vijon:

### **Për aftësitë profesionale**

#### *a) Njohuritë ligjore*

Subjekti i rivlerësimit ka shfaqur aftësi shumë të mira në drejtim të njohjes, interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret, kualifikon saktë marrëdhënien juridike, vendimet e saj të ankmuara nga palët mbeten në fuqi në gjykatat më të larta, me përjashtim të një vendimi, i cili u ndryshua pjesërisht.

#### *b) Arsyetimi ligjor*

Subjekti i rivlerësimit ka shfaqur nivel të lartë profesional duke i kushtuar mjaft vëmendje arsyetimit ligjor të vendimeve të dhëna prej saj. Mendimi juridik për çështjet që identifikohen të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes është i thellë në analizë dhe në koncepte të së drejtës dhe transmetohet me një gjuhë profesionale dhe të qartë. Niveli i arsyetimit të

<sup>17</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.4.2021, të SPAK-ut në dosjen e Komisionit.



vendimeve të vëzhguara respekton plotësisht standardin e procesit të rregullt ligjor. Vendimet e ndërmjetme shoqërohen gjithnjë me referencë ligjore dhe, kur duhet, jepen arsye për dhënien e tyre.

### **Për aftësitë organizative**

#### *a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*

Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në të dhëna, është 92.31%. Në interpretim të pikës 3, shkronja “c” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari administrativ i shkallës së parë duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 150 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje administrative. Ky rregull nënkupton një ngarkesë sasiore prej jo më pak se 450 gjykime çështjesh të tilla për tre vjet. Ndërkohë, gjyqtarja Elda Vrioni, për tre vjet ka përfunduar së gjykuari 1173 çështje administrative me palë kundërshtarë. Nga të dhënat statistikore, gjyqtarja Elda Vrioni ka pasur ngarkesë sasiore shumë të lartë që përbën më tepër se dyfishin e standardit minimal. Znj. Elda Vrioni është efiçiente dhe efektive në çështjet që ajo ka gjykuar me gjithë ngarkesën sasiore tepër të lartë me çështje të gjykuara.

#### *b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore*

Gjyqtarja Elda Vrioni ka shfaqur aftësi shumë të mira për të kryer procedurat gjyqësore. I njofton të paditurit aktet dhe i cakton afat atij për paraqitjen e prapësimeve dhe provave, aktet e paraqitura prej të paditurit ia njofton paditësit, zhvillon seancë përgatitore dhe kur vlerëson se aktet janë të plota e kalon çështjen për gjykim. Nuk rezultoi në asnjë rast që të jetë cenuar ndonjë vendim i gjyqtarës Elda Vrioni nga gjykatat më të larta, për mosrespektim apo për shkelje të procedurave gjyqësore.

#### *c) Aftësia për të administruar dosjet*

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short nuk është konstatuar asnjë mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të.

### **Për etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale**

#### *a) Etika në punë*

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohet asnjë e dhënë negative për etikën në punë të gjyqtarës Elda Vrioni, për periudhën objekt i këtij vlerësimi profesional. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

#### *b) Integriteti*

Nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Në Inspektoratin e ish-KLD-së, gjatë periudhës së rivlerësimit profesional nuk rezultoi të jenë regjistruar ankesa, ku të vihet në dyshim integriteti i gjyqtarës Elda Vrioni.

#### *c) Paanësia*

Nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve, nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme.

### **Për aftësitë personale dhe angazhimin profesional**

#### *a) Aftësitë e komunikimit*

Gjyqtarja Elda Vrioni komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Ajo ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve. Gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

#### *b) Aftësia për të bashkëpunuar*

Nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e gjyqtarës Elda Vrioni për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Të dhënat e rezultuara nga shqyrtimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara tregojnë se bashkëpunimi i saj me administratën gjyqësore dhe kolegët ka qenë në nivelin e duhur.

#### *c) Gatishmëria për t'u angazhuar*

Subjekti i rivlerësimit i ka kushtuar rëndësi formimit akademik. Ajo i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 10 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës. Lënda e trajnimeve, ku ajo ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative. Znj. Elda Vrioni ka qenë eksperte në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në 2 aktivitete trajnuese me tema të ndryshme, gjithsej 3 ditë. Ka kryer edhe trajnime të tjera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, trajnime të organizuara nga institucione ndërkombëtare si Këshilli i Evropës, OSCE, RESPA, ku në fokus të tyre kanë qenë çështje që lidhen me gjykimet apo drejtësinë administrative. Gjyqtarja Elda Vrioni është bashkautore e tekstit “Manual i akteve procedurale për gjykimet administrative”, projekt i realizuar në bashkëpunim me OSCE – gusht 2016.

### **Informacion i marrë nga të dhënat arkivore**

**30.** Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Elda Vrioni janë paraqitur gjithsej 4 ankesa në Inspektoratin e KLD-së dhe pasi janë verifikuar ka rezultuar se: (i) 2 ankesa të vitit 2014, verifikuar për zvarritje, i janë regjistruar gjyqtarës për efekt vlerësimi profesional, për të cilat nga Komisioni u kryen verifikime të mëtejshme; (ii) 1 ankesë e vitit 2015, verifikuar për mosrespektim formal ligji, është arkivuar me arsyetimin se nuk rezultuan shkelje në veprimtarinë e gjyqtarës, për të cilën nga ana e Komisionit nuk u vlerësua e nevojshme kryerja e hetimeve të mëtejshme; (iii) 1 ankesë e vitit 2016, verifikuar për mosrespektim formal ligji, është dërguar për trajtim në Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, për të cilën, pas verifikimeve nga ana e Komisionit, nuk u konstatuan gjetje, trajtuar te denoncimet.

Në lidhje me dy ankesat e vitit 2014, verifikuar për zvarritje, të cilat i janë regjistruar gjyqtarës për efekt vlerësimi profesional, Komisioni iu drejtua KLGJ-së<sup>18</sup> për vënien në dispozicion të praktikave, nga shqyrtimi i të cilave rezultoi se:

**a.** Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i është drejtuar KLD-së me shkresën datë 23.7.2014, duke pretenduar në thelb për zvarritje. Pas verifikimit, inspektorët e KLD-së në datën 21.11.2014 kanë relatuar verifikimin e ankesës, ku në përfundim janë shprehur se nisur nga shkaqet e justifikuara të shtyrjes së seancave gjyqësore dhe planifikimi i veprimeve apo i seancave në kohë relativisht të gjatë, si dhe duke marrë në konsideratë ngarkesën në punë të gjyqtarëve në këtë gjykatë, e cila është shumë e lartë, kanë konkluduar se bazuar në nenin 34/2 të rregullores për organizimin e funksionimin e IKLD-së, çmohet evidentimi i zvarritjes së gjykimet, për efekt vlerësimi profesional dhe etik ndaj gjyqtarës së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Elda Vrioni.

<sup>18</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2024, të KLD-së, në dosjen e Komisionit.

b. Shtetasi P. S. ka paraqitur ankesë në KLD në datën 26.12.2014 ndaj gjyqtares Elda Vrioni në lidhje me vendimin nr. \*\*\*, datë 10.4.2014, duke pretenduar ndër të tjera se vendimi është zbardhur me vonesë. Inspektorët e KLD-së në datën 30.3.2015 kanë relatuar verifikimin e ankesës së shtetasit P. S. për mosdorëzim në kohë të vendimit, duke konkluduar se bazuar në nenin 34/2 të rregullores për organizimin e funksionimin e IKLD-së shkelja e konstatuar në drejtim të afatit të dorëzimit të vendimit gjyqësor të arsyetuar, t'i mbahet në konsideratë gjyqtares Elda Vrioni për efekt vlerësimi profesional dhe etik. Me shkresën datë 22.6.2015, KLD-ja ka informuar shtetasin P. S. se vendimi nr. \*\*\*, datë 10.4.2014 është dorëzuar në sekretari në datën 27.4.2014, për një afat kohor 17 ditë nga shpallja e tij dhe se nga ana e gjyqtares nuk është respektuar afati 7-ditor, si dhe e kanë informuar se gjyqtarja Elda Vrioni ka pasur mbingarkesë në punë në këtë 4-mujor me 112 çështje në gjykim, ndërkohë që standardi për këtë kategori të çështjes është 150 çështje në vit.

**30.1.** Me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ subjektit iu kërkuan sqarime për zvarritje për të dyja rastet e mësipërme. Në parashtrimet e veta, subjekti, pasi u shpreh se dakordësohej me të gjitha përfundimet e arritura, në mënyrë të përmbledhur parashtroi se:

Për rastin e parë sqaroi se çështja në fjalë ka gjithsej 2 seanca përgatitore (përfshirë këtu edhe veprimet e para në dhomë këshillimi) dhe çështja ka kaluar për gjykim në vetëm një seancë, ku janë njoftuar palët të jenë të pranishme. Janë gjithsej 4 seanca gjyqësore, ndër të cilat, seanca e parë e datës 21.7.2014 nuk është zhvilluar për shkak se gjyqtarja ka qenë me raport për probleme shëndetësore; datat 2 dhe 15.10.2014 kanë qenë hetim gjyqësor i zhvilluar në dy seanca për shkak se është vlerësuar kërkimi i një prove; seanca e fundit ka qenë shpallja e vendimit. Ankuesi ankohet për zvarritje, e cila lidhet me mosrespektimin e neneve 25 dhe 27 të ligjit nr. 49/2012. Në fakt, për shkak se veprimet e para përgatitore sipas parashikimit të nenit 25 të ligjit nr. 49/2012 janë në çdo rast detyrim për gjyqtarin e gjykatës administrative, efektivisht ato janë kryer brenda 4 ditëve nga paraqitja e padisë. Po kështu, përfundimi i fazës përgatitore vetëm me një seancë dhe hetimi gjyqësor vetëm në dy seanca, pasi një tjetër nuk është zhvilluar për mungesë të gjyqtarit dhe e fundit për shpallje, sipas subjektit nuk i përgjigjen një gjykimi të zvarritur. Sipas subjektit, edhe Inspektorati i KLD-së ka konkluduar se të gjitha shkaqet e shtyrjes janë të justifikuara. Në aspektin e kohëzgjatjes së gjykimit, që nga koha e regjistrimit të padisë i vetmi moment lidhet me afatin e kalimit në seancë gjykimi që rezulton 1 muaj në raport me 15 ditë, por kjo ka lidhje të drejtpërdrejtë me ngarkesën e lartë të punës.

Për rastin e dytë lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit në kapërcimin e afatit 7-ditor, subjekti rendit shkaqet që kanë ndikuar si, ngarkesa e lartë e punës gjatë vitit 2014 për secilin gjyqtar të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, trajtuar edhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, ku është shprehur se gjyqtarja e çështjes ka pasur mbingarkesë në punë në 4-mujorin e parë të vitit me 112 çështje në gjykim, ndërkohë që standardi për këtë kategori çështjesh është 150 çështje në vit. Në vitin e parë efektiv të punës në gjykatën administrative, 2014, kushtet e ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore ishin më të vështira, nisur nga fakti që seancat zhvilloheshin në zyrat e gjyqtarëve dhe mundësia e arsyetimit të vendimeve ishte vetëm në orët e pasdites apo fundjavës. Vonesa prej disa ditësh, në fakt nuk i ka cenuar ankuesit asnjë të drejtë, pasi vendimi në fjalë ishte i formës së prerë për shkak të ligjit, pra, pa mundësi për të paraqitur ankim në gjykatën më të lartë dhe disponimi ishte për rrëzim të padisë, pra, nuk ka penguar as ekzekutim të vendimit në kushtet kur padia është rrëzuar. Sipas subjektit, duhet mbajtur në konsideratë edhe parashikimi i ndryshuar procedural në vitin 2017 për afatin e arsyetimit të vendimit për 20 ditë<sup>19</sup>, afat i cili merret referues sot nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në kushtet e sistemit të ri të vlerësimit, që sipas saj, duhet çmuar se afati i depozitimit të vendimit në rastin konkret nuk mund të konsiderohet i pajustificuar në raport me standardin e ligjit.

<sup>19</sup> Neni 308 i Kodit të Procedurës Civile, paragrafi i dytë: "Gjykata mund të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit, duke e dorëzuar atë të arsyetuar në sekretari jo më vonë se njëzet ditë ose të shtjës shpalljen e arsyetuar të vendimit, deri në njëzet ditë".

Subjekti sqaroi se për vitin 2014 ngarkesa e punës së gjykatës ka qenë shumë e lartë, edhe për shkak të çështjeve që kanë ardhur për kompetencë lëndore shqyrtimi nga gjykatat e rretheve gjyqësore, për shkak të efekteve të Vendimit Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3/2013. Nga ana e subjektit janë përfunduar 490 çështje<sup>20</sup>, nga ku 115 kanë qenë urdhra ekzekutimi, pra të përfundueshme me një seancë, ndërsa shumë prej tyre kanë pasur ecurinë e seancave në varësi të specifikës së secilës. Po kështu, numri i çështjeve për shqyrtim ka qenë edhe më i lartë në raport me numrin e çështjeve të vendimuar, pasi ka pasur çështje të mbartura vitin e mëpasshëm të punës. Sipas të dhënave statistikore për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve, miratuar nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe i zbatueshëm për kohën e paraqitjes së ankesës, rezultoi se numri i çështjeve për gjykim të natyrës administrative duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 150 çështje (pika 3, shkronja “c” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit). Në vitin 2014, subjekti ka përfunduar çështje si relatores 2.5 herë më shumë sesa numri i çështjeve të caktuara si standard sasior. Në këtë aspekt, nëse ngarkesa ka qenë 2.5 herë më e lartë sesa duhej të ishte, shtrirja në kohë e disa seancave në raport me normalitetin e veprimtarisë gjyqësore është e justifikuar.

**30.2.** Në analizë të sqarimeve të paraqitura nga subjekti, nga ana e Komisionit vlerësohet se ato janë të plota dhe bindëse dhe në përfundim çmohet se vonesat e konstatuara, ashtu siç dhe është shprehur në kohë edhe vetë KLD-ja, kanë ardhur për shkaqe objektive.

### **Denoncimet nga publiku**

**31.** Në total janë administruar 21 denoncime, në dy raste të përsëritura, pas analizimit të të cilave, për tetë prej tyre janë kryer verifikimet si vijojnë:

#### **Denoncim<sup>21</sup> nga shtetasi E. Gj.**

**32.** Denoncuesi ngre pretendime për zvarritje të procesit gjyqësor nga subjekti i rivlerësimit. Sipas tij, me fletëthirrje nr. akti \*\*\*, datë 22.10.2021, vule protokollit datë 4.11.2021, subjekti ka lajmëruar se në datën 17.11.2021 fillon gjykimi i çështjes, ndërsa vendimi i gjykatës për mospranimin e kërkesëpadsisë është marrë në muajin maj të vitit 2022, pra pas rreth 8 muajsh. Gjithashtu pretendon se edhe pse po kalon muaji qershor i vitit 2022 subjekti ende nuk ka zbardhur vendimin duke i shkaktuar dëm në lidhje me të drejtën e ankimit. Bashkëngjitur ka paraqitur fletëthirrjen e cituar.

**32.1.** Gjatë procesit, subjektit iu kërkuan sqarime dhe dokumente në lidhje me pretendimet e denoncuesit, e cila në përgjigje të pyetësorit nr. 2 sqaroi se vendimi të cilit i referohet denoncuesi është vendimi nr. \*\*\*, datë 28.4.2022, gjykuar prej saj, me të cilin ka vendosur rrëzimin e padsisë. Sa i takon pretendimit për zvarritje, sqaroi se shtetasi E. Gj. ka paraqitur padi në gjykatën administrative në datën 9.7.2015 dhe me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.9.2015, gjykata ka vendosur rrëzimin e padsisë. Me ankimin e këtij vendimi, gjykata e apelit, me vendimin nr. \*\*\*, datë 8.2.2017, ka vendosur prishjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 21.9.2015, dhe kthimin për rigjykim me tjetër trup gjykues. Është ushtruar rekurs dhe Gjykata e Lartë me vendimin datë 21.7.2021 ka vendosur mospranimin e rekursit.

**32.2.** Në lidhje me veprimet e kryera pas reregjistrimit të padsisë (trajtuar nga subjekti), subjekti dha informacion të detajuar, shoqëruar me dokumentacion ligjor<sup>22</sup>, pasqyruar hollësisht në rezultatet e hetimit, në analizë të të cilave konstatohet se pretendimet e denoncuesit nuk qëndrojnë, pasi sa i takon ecurisë së procesit gjyqësor, në asnjë rast nuk ka pasur seanca joproductive për shkak të subjektit me përjashtim të një seance, e cila ka qenë me raport mjekësor, pra për shkaqe objektive. Po ashtu, edhe sa i përket pretendimit se edhe në muajin qershor nuk është zbardhur vendimi, rezultoi i pabazuar pasi vendimi është dorëzuar në sekretari 7 ditë pas shpalljes. Si përfundim, në rastin konkret, referuar nenit 74 të ligjit nr.

<sup>20</sup> Subjekti ka paraqitur kopjen e analizës vjetore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për vitin 2014, ku paraqiten 490 çështje të gjykuara, kërkesa të gjykuara 115, nga ana e subjektit.

<sup>21</sup> Shihni denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 17.6.2022.

<sup>22</sup> Shihni përgjigjen e pyetjes nr. 6 të pyetësorit nr. 2 dhe dokumentacionin bashkëngjitur.

96/2016, subjekti, me veprimet dhe sjelljen e tij nuk ka treguar mangësi për të kryer procedurat gjyqësore, respektimin e afateve ligjore apo kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

### **Dy denoncime<sup>23</sup> nga \*\*\***

**33.** Denoncuesi pretendon se pranë tij ka paraqitur ankesë shtetasi R. T., ankesë që së bashku me disa dokumente i ka përcjellë pranë Komisionit. Nga përmbajtja e kësaj ankese vërehet se ky shtetas ngre pretendime në lidhje me aftësitë profesionale të subjektit ose veprime keqdashëse, shkelje të etikës, zvarritje të procesit. Denoncuesi pretendon se data e shpalljes së vendimit nr. \*\*\*, datë 25.9.2017 është shtyrë dy herë dhe herën e fundit u shty me 7 ditë në kundërshtim me nenin 42 të ligjit nr. 49/2012, duke dhënë një vendim të paarsyetuar në kundërshtim me nenin 42/1. Sipas tij, vendimi i arsyetuar i është komunikuar nga shërbimi postar në datën 9.10.2017, për shkak të vonesës së zbardhjes së vendimit të arsyetuar. Ngre pretendime për mosanalizë të pretendimeve të listuara në kërkesëpadi, moszbatim dhe mosnjohje të ligjit dhe neglizhencë. Bashkëlidhur janë paraqitur vendimi nr. \*\*\*, datë 8.7.2018, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, si dhe vendimi nr. \*\*\*, datë 25.9.2017, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të dhënë nga subjekti.

**33.1.** Gjatë procesit, subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me pretendimet e denoncuesit, e cila në përgjigje të pyetësorit nr. 2 fillimisht sqaroi se me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.9.2017, shtetasit T. i është rrëzuar padia dhe për këtë vendim Gjykata e Apelit, me vendimin e saj nr. \*\*\*, datë 8.7.2018, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë dhe se me rekursin e paraqitur nga Avokatura e Shtetit, çështja ndodhet për gjykim pranë Gjykatës së Lartë. Në vijim, subjekti ka dhënë sqarime<sup>24</sup> dhe ka argumentuar në mënyrë të detajuar çdo pretendim të denoncuesit/ankuesit, pasqyruar hollësisht në rezultatet e hetimit administrativ.

Në analizë të shpjegimeve dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, konstatohet se pretendimet e denoncuesit janë të pabazuara pasi:

- Sa i takon ecurisë së procesit gjyqësor, në asnjë rast nuk ka pasur seanca joproductive, për shkak të subjektit me përjashtim të një seance për shpallje vendimi, e cila ka qenë me raport mjekësor, pra për shkaqe objektive, si dhe shpallja është bërë brenda afatit 5-ditor dhe jo 7-ditor, siç pretendohet. Po ashtu, edhe sa i përket pretendimit se ka zvarritur zbardhjen e vendimit rezulton i pabazuar, pasi vendimi është dorëzuar në sekretari brenda afatit ligjor 7-ditor. Si përfundim, në këtë drejtim, në rastin konkret referuar nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, subjekti me veprimet dhe sjelljen e tij nuk ka treguar mangësi për të kryer procedurat gjyqësore, respektimin e afateve ligjore apo kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

- Lidhur me pretendimet e denoncuesit mbi aftësitë profesionale/njohje të ligjit për mungesë të analizës së kërkimeve në padi, janë pretendime të denoncuesit mbi mënyrën e zgjidhjes së çështjes nga subjekti, pra që në thelb kanë të bëjnë me themelin e çështjes dhe referuar nenit 72/4 të ligjit nr. 84/2016 sipas të cilit *vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet*, nuk është në kompetencën e Komisionit të gjykojë mbi korrektësinë e vendimit dhe themelit të çështjes, tagra këto të cilat janë në kompetencë të një gjykate më të lartë. Siç rezulton, nga subjekti është rrëzuar padia, ndërsa apeli ka vlerësuar praninë pjesërisht të padisë, duke u shprehur ndër të tjera se *...gjykata e shkallës së parë ka bërë analizë tërësore dhe objektive ...gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejt kur ka analizuar aktin administrativ, por ky kolegji vlerëson ndryshe ligjshmërinë e aktit administrativ*. Çështja tashmë është në Gjykatën e Lartë, e cila, edhe kjo e fundit, potencialisht mund të bëjë vlerësim të ndryshëm të themelit të çështjes.

<sup>23</sup> Shihni denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 20.2.2022 dhe nr. \*\*\* prot., datë 20.2.2022.

<sup>24</sup> Shihni përgjigjen e pyetjes nr. 7 të pyetësorit nr. 2 dhe dokumentacionin bashkëngjitur.

- Lidhur me pretendimet në drejtim të etikës, nisur nga shpjegimet e subjektit, shqyrtimi i procesverbaleve të paraqitura nga subjekti dhe vendimet e gjykatave, nuk evidentohen veprime apo sjellje të subjektit jo në përputhje me vlerat dhe parimet në referim të parashikimeve të neneve 3, 4 dhe 75 të ligjit nr. 96/2016.

### **Denoncim<sup>25</sup> nga shtetasi A. Q.**

**34.** Denoncuesi ngre pretendime për zvarritje në një çështje ku ka qenë palë paditëse. Sipas denoncuesit, subjekti nuk ka pranuar padinë e tij, ai e ka ankimuar dhe apeli pas 2 vitesh e ka kthyer për gjykim në gjykatën civile të shkallës së parë. Bashkëngjitur ka paraqitur: (i) kërkesëpadi me objekt “Anulim të ekspertimit psikiatriko - ligjor nr. \*\*\* të dhënë nga Dr. L. A. dhe Dr. A. K. në datën 10.12.2014, si dhe dëmshpërblim prej 300 mijë lekësh për dëmin e shkaktuar”; (ii) ankim ndaj vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit; (iii) tri faqe të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit datë 9.5.2018, i cili ka prishur vendimin nr. \*\*\*, datë 29.3.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në gjykatën kompetente, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku ndër të tjera është arsyetuar se: “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjatë gjykimit të çështjes penale nr. \*\*\* akti, datë 7.7.2014, në ngarkim të paditësit A. Q. ka vlerësuar se për një hetim të plotë e të gjithanshëm duhet të kryhej ekspertimi psikiatriko-ligjor për paditësin A. Q. dhe ka caktuar për këtë si eksperte psikiatriko-ligjore, Dr. I. A. dhe Dr. A. K. (vendim i marrë në seancë gjyqësore të datës 30.10.2014).

*Kolegji vlerëson së në referim të neneve 1. b, 4, 7 dhe 17 të ligjit nr. 49/2012, konstatohet se mosmarrëveshja e paraqitur për shqyrtim para Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nuk është një mosmarrëveshje e natyrës administrative duke qenë se padia ka për objekt anulimin e aktit të ekspertimit psikiatriko - ligjor nr. \*\*\*, datë 10.12.2014, përpiluar nga Shërbimi i Mjekësisë Ligjore, e cila përbën një provë të caktuar në gjykimin penal nr. \*\*\* të vitit 2014.*

*Gjykata Administrative e Apelit, në zbatim të nenit 13.1 të ligjit nr. 49/2012 arrin në përfundimin se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë nuk ishte kompetente nga pikëpamja lëndore për shqyrtimin e çështjes objekt gjykimi, duke qenë se padia në thelb ka kundërshtimin e një akti ekspertimi, e cila ka qenë pjesë gjykimi i një procedimi penal, akt ky që gjen rregullim të posaçëm në Kodin e Procedurës Penale”.*

Gjatë procesit, subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me pretendimet e denoncuesit për zvarritje, si dhe në lidhje me konstatimin e gjykatës së apelit, shoqëruar me dokumentacion ligjor, e cila në përgjigje të pyetësorit nr. 2 sqaroi se pas vendimit të apelit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 12.4.2019, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, si e pabazuar në prova dhe në ligj dhe se çështja ndodhet në apel. Më tej ka sqaruar se vendimi i dhënë prej saj nuk ka trajtuar çështjen e kompetencës lëndore, duke dhënë sqarime të hollësishme bazuar në argumente e dokumente shkresore, pasqyruar në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ.

Në analize të të deklarimeve dhe dokumentave që subjekti paraqiti, u vërtetua se: (i) vetë pala paditëse i është drejtuar gjykatës administrative për kundërshtimin e një akti administrativ, duke kërkuar edhe dëmshpërblim; (ii) palët në proces nuk kanë ngritur pretendime në lidhje me kompetencën lëndore; (iii) padia është paraqitur jashtë afatit dhe në këtë drejtim subjekti ka vepruar drejt duke mospranuar padinë për shkak të paraqitjes jashtë afatit ligjor; (iv) duke qenë se padia formalisht nuk mund të merrej në shqyrtim nga gjykata administrative, çështja lëndore e ngritur nga Gjykata e Apelit është vlerësim i kësaj të fundit dhe, siç rezultoi, sërish padia nuk është trajtuar nga seksioni penal i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, por nga seksioni civil. Në këto kushte, pretendimet e denoncuesit nuk qëndrojnë.

<sup>25</sup> Shihni denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 13.7.2018.

## **Denoncim<sup>26</sup> nga shtetasja E. F.**

**35.** Denoncuesja ngre pretendime për korrupsion dhe shpërdorim detyre ndaj një grupi gjyqtarësh, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit. Sa i takon subjektin nuk paraqet ndonjë rrethanë apo fakt konkret për ndonjë shkelje, por është shprehur se ish-KLD-ja e ka njoftuar se ka filluar procedim disiplinor. Bashkëngjitur ka paraqitur një kallëzim penal ndaj disa gjyqtarëve, përfshirë edhe subjektin, por që ndaj saj nuk referon ndonjë shkelje konkrete. Për këtë kallëzim<sup>27</sup> është vendosur mosfillim. Sipas denoncueses, subjekti ka pranuar ankimin jashtë afatit ligjor.

Komisioni iu drejtua ILD-së<sup>28</sup> dhe kjo e fundit informoi se pas verifikimit të ankesës ka vendosur arkivimin e saj, duke përcjellë edhe vendimin përkatës nr. \*\*\* prot., datë 12.5.2021. Nga shqyrtimi i këtij vendimi rezulton se ILD-ja e ka arkivuar çështjen për shkak se shkelja e pretenduar është parashkruar duke qenë se ka kaluar afati 5-vjeçar, pra pa e trajtuar ankesën në themel. Për rrjedhojë, Komisioni analizoi rrethanat e pasqyruara në këtë vendim, si vijon:

- Nga përmbajtja e ankesës rezulton se Gjykata e Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka shqyrtuar çështjen me palë paditëse E. F. dhe palë të paditur Ministrinë e Mbrojtjes dhe DPA-në. Gjyqtarja Elda Vrioni, me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.12.2015, ka vendosur pranimin e padisë, ndërkohë palët kanë qenë në mungesë në shpalljen e vendimit.

- Palët e paditura kanë marrë dijëni në datën 21.1.2016, DAP-i ka paraqitur ankim në datën 5.2.2016, ndërkohë që afati i ankimit përfundonte më 4.2.2016 dhe gjykata, me vendimin datë 26.2.2016, ka pranuar ankimin duke e dërguar çështjen në Apel.

- Ish-inspektori i KLD-së, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, ka vendosur verifikimin ndaj gjyqtarës Elda Vrioni. Është marrë dokumentacioni dhe janë marrë deklaratimet e gjyqtarës Elda Vrioni, e cila ka sqaruar se çështja ka të bëjë me një vendimmarrje për pranimin e ankimit në shkallë të dytë, i bërë nga DAP, ku është vendosur pranimi i ankimit në vlerësim të faktit që ishte brenda afatit, sikurse është vendosur mospranimi i ankimit të Ministrisë të Mbrojtjes pasi ishte paraqitur jashtë afatit.

Sa më sipër, nisur nga faktet rezulton se ankesa e shtetasës E. F. si palë gjyqfituese ka të bëjë me pretendimin e saj se afati i ankimit përfundonte në datën 4.2.2016 dhe se subjekti i rivlerësimit ka pranuar ankimin e palës paditëse DAP të paraqitur në datën 5.2.2016 jashtë afatit 15-ditor. Në rastin konkret, referuar rrethanave: vendimi është shpallur në mungesë, palët kanë marrë dijëni në datën 21.1.2016, afati i paraqitjes së ankimit në gjykatën administrative ka të njëjtin rregullim nga ai i parashikuar në Kodin e Procedurës Civile, vetë ligji nr. 49/2012 në nenin 44 parashikon se mjetet dhe afatet e ankimeve janë të njëjta me ato të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka vepruar drejt duke konsideruar ankimin si të paraqitur brenda afatit pasi sipas afateve ligjore, dita e fundit e paraqitjes së ankimit përkon në datën 5.2.2016.

## **Denoncim<sup>29</sup> nga shtetasi P. K.**

**36.** Denoncuesi ngre pretendime që kanë të bëjnë me çështje pronësie që nga viti 1993. Sa i takon subjektin të rivlerësimit si gjyqtarë, pretendon se ka gjykuar një kërkesëpadi që, sipas tij, në fillim e mbylli çështjen dhe nuk e ka njoftuar për seancën gjyqësore. Pas dy muajsh, me interesimin e tij e ka rihapur çështjen dhe i ka dhënë vendim negativ. Bashkëngjitur ka paraqitur disa dokumente, por nuk ka paraqitur asnjë dokument të dalë nga subjekti apo drejtuar subjektin.

Gjatë procesit, subjektin iu kërkuan sqarime në lidhje me pretendimet e denoncuesit, e cila në përgjigje të pyetësorit nr. 2 sqaroi se shtetasi P. K. ka pasur dy procese gjyqësore për të cilat

<sup>26</sup> Shihni denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 2.12.2019.

<sup>27</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.4.2021, të SPAK-ut në dosjen e Komisionit, vendim mosfillimi të procedimit.

<sup>28</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.1.2024, të ILD-së, në dosjen e Komisionit.

<sup>29</sup> Shihni denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 2.5.2018.

dha shpjegime të hollësishme shoqëruar me dokumentacion shkresor<sup>30</sup>, pasqyruar në mënyrë të hollësishme në rezultatet e hetimit administrativ, nga analizimi i të cilave konstatohet se pretendimet e denoncuesit se subjekti nuk e ka njoftuar për seancën gjyqësore dhe se pas dy muajsh, me interesimin e tij, e ka rihapur çështjen, nuk qëndrojnë për sa kohë që, në rastin e parë çështja nuk ka kaluar në seancë gjyqësore, është njoftuar në adresën e vendosur në kërkesëpadi, është vendosur kthimi i padisë për shkak të të metave të saj dhe vendimi i është njoftuar. Sa i përket rastit të dytë ku si palë gjyqëmbëse, sipas tij, vendimi i është dhënë negativ, vërehet se në thelb ka të bëjë me themelin e çështjes dhe bazuar në pikën 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohet se nuk është në kompetencën e Komisionit të gjykojë mbi korrektësinë e vendimit dhe themelit të çështjes, tagra këto të cilat janë në kompetencë të një gjykate më të lartë, që në rastin konkret e ka lënë në fuqi.

Bazuar në dokumentet e paraqitura nga subjekti, duket se ka qenë një seancë joproductive ajo e datës 11.5.2016, kjo, për shkak se palët nuk janë njoftuar nga gjykata. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkuan sqarime, e cila në qëndrimin e saj, ndër të tjera, sqaroi<sup>31</sup> si vijon:

- Kjo seancë është në kuadër të padisë së parë së depozituar në gjykatë nga z. K., në datën 18.4.2016 dhe në datën 20.4.2016 janë kryer veprimet e para përgatitore (brenda afatit 7-ditor nga paraqitja e padisë, sikundër e parashikon neni 25 i ligjit nr. 49/2012). Seanca përgatitore në prani të palëve është caktuar në datën 11.5.2016, ora 15:30, ndërsa është disponuar për komunikimin ndaj palëve të paditura dhe Avokaturës së Shtetit të padisë dhe akteve shoqëruese të saj, duke iu komunikuar seanca të gjitha palëve. Në procesverbalin e datës 20.4.2016, subjekti ka urdhëruar sekretarinë gjyqësore për kryerjen e njoftimeve. Seanca përgatitore datë 11.5.2016 është shtyrë, pasi asnjë nga palët nuk ka qenë e pranishme dhe asnjë nga njoftimet për seancën nuk ishte kthyer, ndërsa ishin kthyer aktet për njoftimet e padisë. Për nevoja të procesit të rregullt, është shtyrë seanca për datë 26.5.2016. Për këtë rast subjekti shpjegon se:

Së pari, marrja dijëni e palëve për gjykimin është kusht kryesor për rregullsinë e procesit, ndaj në kushtet kur palët nuk provohet të kenë dijëni, shtyrja është e pashmangshme. Në këtë aspekt, efektiviteti i seancës nuk prevalon ndaj njoftimit efektiv të palëve.

Së dyti, gjykata ka detyrimin për të urdhëruar kryerjen e njoftimeve për datën e caktuar të seancës, sikundër ka ndodhur, por efektivisht njoftimet përpilohen nga sekretarja gjyqësore, siç i parashikon neni 77, paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile<sup>32</sup>.

Së treti, në rastin konkret, ashtu si rezulton nga përmbajtja e procesverbalit të datës 11.5.2016, “nuk konfirmohet marrja dijëni” për palët, nuk përjashtohet mundësia që pala pa këtë njoftimin, por kopja e tij nuk është kthyer. Kjo pasi, njoftimet për seancë, urdhërohen të kryhen së bashku me njoftimet për komunikimin e padisë dhe akteve shoqëruese ndaj palëve të tjera dhe Avokaturës së Shtetit. Në dosje janë kthyer të gjitha njoftimet për komunikimin e padisë dhe akteve shoqëruese subjekteve të paditura dhe Avokaturës së Shtetit.

Në analizë të parashtrimeve dhe dokumenteve të paraqitura nga subjekti, ashtu siç është konstatuar nga Komisioni dhe në rezultatet e hetimit administrativ, duket se subjekti në datën 20.4.2016 ka vendosur njoftimin e padisë dhe të akteve, të cilat u janë komunikuar palëve, si dhe ka caktuar zhvillimin e seancës për në datën 11.5.2016, njoftimi i së cilës është detyrë e sekretarisë gjyqësore së bashku me njoftimin e padisë, por që nuk rezultoi të jetë njoftuar. Në këtë rast subjekti për shmangien e seancës joproductive, duhet të mbikëqyrte dërgimin e akteve

<sup>30</sup> Shihni përgjigjen e pyetjes nr. 9 të pyetësorit nr. 2 dhe dokumentacionin bashkëngjitur.

<sup>31</sup> Sa i përket dokumenteve, subjekti sqaron se gjenden në aktet procedurale të depozituara lidhur me denoncimin e z. P. K., në përgjigje të pyetësorit nr. 2, si: procesverbal i veprimeve të para përgatitore datë 20.4.2016; njoftimet për padinë dhe aktet subjekteve të paditura dhe avokaturës së shtetit; procesverbal i seancës përgatitore datë 11.5.2016.

<sup>32</sup> Sekretari regjistron çështjet, formon fashikujt gjyqësorë, duke futur atje dokumente ose kopje të tyre të vërtetuara sipas ligjit dhe shënon menjëherë datën e depozitimit, i ruan ato, përpilon komunikimet dhe njoftimet e parashikuara nga ligji ose nga gjykata dhe detyra të tjera që lidhen me procesin gjyqësor.



të nevojshme të njoftimit, por në përfundim nga ana e Komisionit, ky rast çmohet se në vetvete nuk mbart ndonjë peshë për efekt të procesit të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit.

### **Denoncim<sup>33</sup> nga shtetasi H. M.**

**37.** Denoncuesi ngre pretendime për zvarritje ndaj një grupi gjyqtarësh, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit. Sa i takon subjektit të rivlerësimit pretendon se ka depozituar një kërkesëpadi në datën 22.10.2012, por subjekti edhe pas një viti nuk ka dhënë vendim dhe më pas çështja u transferua në gjykatën e administrative. Bashkëlidhur ka paraqitur disa dokumente, por nuk ka paraqitur asnjë dokument të dalë nga subjekti apo drejtuar subjektit.

Gjatë procesit, subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me pretendimet denoncuesit, e cila në përgjigje të pyetësorit nr. 2 dha shpjegime të hollësisht shoqëruar me dokumentacion shkresor<sup>34</sup>, pasqyruar hollësisht në rezultatet e hetimit administrativ, në analizë të cilave vlerësohet se sa i takon ecurisë së procesit gjyqësor, në asnjë rast nuk ka pasur seanca joproduktive për shkak të subjektit me përjashtim të një seance kur ka qenë me raport mjekësor, pra për shkaqe objektive, dhe seancat e tjera janë shtyrë për shkaqe ligjore procedurale, si dhe mbi vetë sjelljen apo kërkesat e palëve. Si përfundim, në rastin konkret, referuar nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, subjekti me veprimet dhe sjelljen e tij nuk ka treguar mangësi për të kryer procedurat gjyqësore, respektimin e afateve ligjore apo kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

### **Denoncim nga shtetasi P. Q.**

**38.** Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit dhe gjyqtarja E. Ç. kanë dhënë vendime të gabuara dhe të pabazuara në ligj dhe prova, duke favorizuar palën kundërshtare. Ndër dokumentet e paraqitura ndodhet edhe vendimi datë 21.3.2017, i dhënë nga subjekti i rivlerësimit, e cila ka pranuar kërkesën e kërkuarit dhe lëshimin e urdhrin të ekzekutimit. Nga përmbajtja e këtij vendimi, pasqyruar hollësisht në rezultatet e hetimit administrativ, nuk konstatohen problematika në vendimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit për lëshimin e urdhrin ekzekutiv.

### **Gjashtë<sup>35</sup> denoncime nga shtetasi S. T.**

**39.** Denoncuesi ngre pretendime ndaj disa gjyqtarëve dhe prokurorëve si grup të strukturuar kriminal që i kanë vjedhur pronën. Sa i takon subjektit të rivlerësimit ngre pretendime në lidhje me vendimin nr. \*\*\*, datë 8.4.2013, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me anëtare Elda Vrioni, A. K. dhe F. B. (S.) që, sipas tij, bashkë me 24 gjyqtare dhe 3 prokurorë kanë dhënë vendime me dokumente të falsifikuara. Gjithashtu pretendon se subjekti duhet të kishte ndaluar strukturën kriminale. Bashkëlidhur ka paraqitur disa dokumente, ndër to edhe disa faqe të vendimit nr. \*\*\*, datë 8.4.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe vendimin nr. \*\*\*, datë 26.6.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë, që e ka prishur atë.

Sipas vendimit nr. \*\*\*, datë 8.4.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga Elda Vrioni, A. K. dhe F. B. (S.), me palë D. T. etj., me objekt “Kundërshtimi dhe ndryshimi i vendimeve të KKKP Durrës”, trupa gjykuese ka vendosur rrëzimin e padisë. Sipas vendimit nr. \*\*\*, datë 26.6.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë, rezulton se vendimi nr. \*\*\*, datë 8.4.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është rrjedhojë e shkeljeve procedurale të lejuara në gjykim dhe, si i tillë, ai në vështrim të nenit 466/ç në lidhje me nenin 467/d/e të Kodit të Procedurës Civile duhet të priset dhe çështja të dërgohet për rigjykim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

Sa i takon pretendimeve të denoncuesit, ato mbetën të paprovuara dhe në thelb kanë të bëjnë me themelin e çështjes dhe bazuar në pikën 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e

<sup>33</sup> Shihni denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 27.4.2018.

<sup>34</sup> Shihni përgjigjen e pyetjes nr. 10 të pyetësorit nr. 2 dhe dokumentet bashkëngjitur.

<sup>35</sup> Shihni denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 10.5.2021; nr. \*\*\* prot., datë 15.1.2020; nr. \*\*\* prot., datë 28.7.2020; nr. \*\*\* prot., datë 22.5.2019; nr. \*\*\* prot., datë 22.5.2019; nr. \*\*\* prot., datë 6.12.2019.

gjqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohet se nuk është në kompetencën e Komisionit të gjykojë mbi korrektësinë e vendimit dhe themelit të çështjes, tagra këto të cilat janë në kompetencë të një gjykate më të lartë.

Gjatë procesit, subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me konstatimet e gjykatës së apelit, e cila në përgjigje të pyetësorit nr. 2, lidhur me shkakun e prishjes së vendimit nr. \*\*\*, datë 8.3.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin e saj nr. \*\*\*, datë 26.6.2014, subjekti dha shpjegime të detajuara shoqëruar me dokumentacion<sup>36</sup>, pasqyruar hollësisht në rezultatet e hetimit administrativ, nga analizimi i të cilave rezultoi se nga pikëpamja e faktit gjykata e shkallës së parë, ku në trup gjykues ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit, nuk ka qenë në dijeni të vdekjes së njëres prej palëve të paditura, fakt që është bërë me dije vetëm gjatë shqyrtimit në apel dhe se nga pikëpamja procedurale, vazhdimi i gjykimit në mungesë është në përputhje me dispozitat procedurale përkatëse. Nga ana e Komisionit është vlerësuar se shpjegimet e subjektit janë të plota dhe të provuara dhe nuk konstatohen problematika.

#### **Denoncim<sup>37</sup> nga shtetasja N. M. (H.)**

**40.** Denoncuesja ngre pretendime ndaj subjektit të rivlerësimit dhe gjyqtarit E. R., për zvarritjen e një procesi gjyqësor në lidhje me çështjen e regjistruar nr. \*\*\*, në datën 2.11.2020, me palë paditëse K. H., N. H., palë e paditur A. M. (notere), me objekt “Shfuqizimi tërësisht i vendimit...”, duke i shtyrë seancat me kërkesa të avokatit të palës paditëse av. R. G., si dhe ngre pretendime në lidhje me kompetencën. Bashkëngjitur ka paraqitur edhe një CD të regjistrimit audio, nuk lexohet.

Nga Komisioni u kërkua dosja gjyqësore, përfshirë edhe regjistrin audio të seancave, si dhe informacion nëse është shqyrtuar nga subjekti Elda Vrioni. Nëse po, kohën që e ka pasur në shqyrtim, si dhe nëse ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj duke vënë në dispozicion aktet përkatëse.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.2.2024, ka informuar se çështja me short elektronik të datës 3.11.2020 i ka kaluar gjyqtarës Elda Vrioni, e cila e ka pasur në shqyrtim për periudhën 3.11.2020 – 7.6.2021 kur gjyqtari E. R. ka marrë në shqyrtim kërkesën për përjashtim dhe ka vendosur pranimin e saj. Dosja gjyqësore ndodhet në shqyrtim pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Bashkëngjitur ka përcjellë RIV, CD audio të seancave të zhvilluara nga subjekti, si dhe vendimin për përjashtimin e subjektit.

Nga përmbajtja e seancave audio vërehet se seancat janë shtyrë për shkaqe si: kërkesa të palëve, mungesa e palëve, kërkesat e gjykatës për informacion, si dhe pritja e kthim përgjigjeve, kërkesa për dorëheqje, etj. Vërehet se të dyja palët kanë ngritur pretendime për njëanshmëri ndaj gjyqtarës.

Sipas vendimit datë 7.6.2021 është arsyetuar se nuk provohet ekzistenca e asnjë prej shkaqeve të përcaktuara në pikat 1 deri 5 dhe nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile, por gjykata nisur edhe nga qëndrimi i gjyqtarës vlerëson se kërkesa e palës së përfaqësuar nga av. R. G. duhet pranuar me qëllim garantimin e një procesi të rregullt, për të shmangur çdo paragjykim për paanësinë.

Sa më sipër, nga analizimi i përmbajtjes së seancave të zhvilluara nga subjekti, si dhe vendimi për përjashtimin e saj, vërehet se shtyrjet e seancave janë bërë për shkaqe procedurale për mbarëvajtjen e procesit gjyqësor, të kërkesave të vetë palëve apo të vetë sjelljes së tyre. Ndërsa qëndrimi, sjellja dhe komunikimi i subjektit me palët ka qenë korrekt. Edhe sa i takon pretendimit të denoncuesit se subjekti ka favorizuar palën paditëse nuk qëndron edhe për faktin se siç rezultoi, vetë pala paditëse, përfaqësuar nga av. R. G., ka kërkuar përjashtimin e subjektit.

<sup>36</sup> Shihni përgjigjen e pyetjes nr. 11 të pyetësorit nr. 2 dhe dokumentet bashkëngjitur.

<sup>37</sup> Shihni denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 21.6.2021.

Në konkluzion të sa më sipër, nuk janë konstatuar veprime apo sjellje të subjektit që tregojnë mangësi të aftësive apo në drejtim të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

**41.** Në përfundim të procesit të vlerësimit të aftësive profesionale u vërtetua se subjekti ka arritur nivel të besueshëm për kriteret e parashikuara në nenet 72, 74, 75 dhe 76 të ligjit nr. 96/2016. Për rrjedhojë, sipas shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

### **SEANCA DËGJIMORE**

**42.** Në datën 19.3.2024, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, u zhvillua seanca dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Elda Vrioni, në përfundim të të cilës ajo kërkoi konfirmimin në detyrë. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit, pasi dëgjoi relatoren e çështjes, komisioneren Firdes Shuli, e cila rekomandoi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Elda Vrioni dhe shpalli vendimin në seancën e datës 20.3.2024, sipas pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

### **QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**43.** Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016. Në të gjitha komunikimet, subjekti ka qenë në çdo rast i gatshëm, duke u treguar tërësisht bashkëpunues, pasi u është përgjigjur me korrektësi dhe brenda afateve të caktuara të gjitha pyetjeve, duke dhënë shpjegime/deklarime për informacionin e kërkuar bazuar në dokumente shkresore, të cilat kanë qenë konsistente dhe në koherencë të plotë me deklaratimet ndër vite dhe atë *Vetting*, qëndrim i cili është mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

### **KONKLUZION PËRFUNDIMTAR**

Bazuar në parimet e barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, si dhe në parimin e proporcionalitetit sipas pikës 5 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të rivlerësimit Komisioni krijoi bindjen se:

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit Elda Vrioni ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë sipas nenit 59/a të ligjit.
- Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit Elda Vrioni ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës sipas nenit 59/b të ligjit.
- Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Elda Vrioni ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 59/c të ligjit.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe në pikën 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

## **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Elda Vrioni, gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 20.3.2024.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Valbona SANXHAKTARI**  
Kryesuese

**Firdes SHULI**  
Relatore

**Olsi KOMICI**  
Anëtar

*Sekretare gjyqësore*  
*Jonida Vrana*